

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 167, Shtator 2017

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

NË RRUGËN E DIJES DHE TË KULTURËS

Shumë kohë përpara se shkolla në Dukagjin, të hidhte hapat e pare, dukagjinasi kane ëndërruar, jo vetëm për liri e pavarësi, por edhe për arsim dhe kulturë, si bazë e domosdoshme për përparimin e çdo kombi. Të huajt që kanë vizituar trevën e Dukagjinit, në fillimet e shekullit të kaluar, por dhe më parë janë mahnitur, jo vetëm nga bukuria e maleve, e natyra me çdo përbërës të saj, por në veçanti me malësoret, që ishin bërë njësh me malet, pjesë e jetës së tyre, nevojë dhe domosdoshmëri për të mbijetuar, për të përballuar sfidat dhe padrejtësitë, e atyre që iu sulen për të rrëmbyer lirinë, krenarinë e vlerat që e bënë të njohur e të vlerëshme shokuj. / NGA ZEF BARI

FAZA E PARË E PËRGATITJES SË KONFERENCËS SHKENCORE, ME TEMË: "100 VJET ARSIM E KULTURË NË DUKAGJIN"

Një qind vjet më parë, pikërisht me datën 2 shkurt 1917, atdhetari At' Shtjefen Gjeçovi, në fshatin e Thethit, pranë kishës, në Qelë, hapi shkollën shqipe, në të cilën djem e vajza të këtij fshati dukagjinasi filluan të shkruajnë e lexojnë shqip. Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në bazë të planit të përgatitjes e zhvillimit të konferencës - shkencore, me temë: "100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin", Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini: e Sekretari i kësaj shoqate, Luigj Shyti, në bashkëpunim me Administratorin e Njësisë, së Shalës, zotin Petrit Arra dhe kryeplakun e këtij fshatit turistik, të fshatit të Thethit, z. Marash Rrgalla, me datën 23 shtator 2017, në prezencën e disa banorëve të këtij fshati, vendosën pllakën përkujtimore, me mbishkrimin: "Këtu, At' Shtjefen Gjeçovi, me 2 shkurt 1917 hapi shkollën shqipe". Pas një kafe nga Paulin Polia u nisëm për në Shkodër. Gjatë rrugës mjaft makina shkonin në Theth, që aq shumë dëshironin të shikonin bukuritë e mahnitshme të kësaj qendre të Alpeve Shqiptare.

"POETI I VIZATUAR NË SHPIRTIN E GRUAS SË TIJ"

**GJERGJ JOZEF KOLA DHE RITA NDOCI VENË SKENË NJË DRAMË
PËR MARTIN CAMAJN**

Petët kanë vetëm datëlindje, poezia i bënë ata të pa vdekshëm. I tillë është Martin Camaj, i gjithmonshëm, Camaj universal, Camaj i të gjithëve, Camaj i ynë, Camaj dhimbja dhe dashura jonë! I larguar vetëm fizikisht nga kjo botë ndërsa poezia e tij rrjedhë si lumë i kristaltë vegimtar me të gjitha mjetet stilistike e estetike. I vlerësuar nga kritika si lirik i ndjeshëm tej mase ndaj motiveve të vendlindjes e fëmijërisë ai gjithë poezinë e tij përpiket të universalizojë me elementet thellësisht shqiptare. Bash në Kryeqytetin e Bavarisë, aty ku Camaj i pari akademik shqiptarë ofro gjysmë shekulli me parë themeloi Katedrën e Albanologjisë, pikërisht në ditën fatlume të lindjes së poetit të shkëlqyeshëm në një sallë të mbushur me adhurues të poezisë, artit dhe kulturës u bë promovimi i dramës "Poeti i vizatuem në shpirtin e gruas së tij", të autorit të mirënjohur shkodranë Gjergj Jozef Kola. Lum ai qytet që i nderon poetet e vet kudo që te jene ata ne bote, ky qytet ka gjithmonë te ardhme! Kjo është sentenca proverbiale, që ka zgjedhur autori të publikojë në statusin e tij, i ngazëllyer pas shfaqjes së suksesshme të dramës së tij, e cila tek publiku solli përjetime emocionuese...



Shkrimtarët, shënjestra e lakmuar e Sigurimit të Shtetit

Shkrimtari dhe publicisti Stani është një ndër nismëtarët e parë, që ka firmosur hapjen e dosjeve në Shqipëri. Sot pas 27 vitesh ai e konsideron këtë proces të vonuar. Ndërsa, mendon se historianët duhet të bëjnë më shumë për të zbardhur të vërtetën e frikshme të diktaturës, pa u përpëlitur midis dogmatizmave dhe presioneve politike. Procesi i hapjes së dosjeve është një ndër nismat më të diskutuara në Shqipëri. Por, çuditërisht ky proces, nuk është aq fort i diskutuar nga viktimat, të cilët duhet të kërkojnë të njohin xhelatët e tyre, sesa nga individë që nuk janë të papërfshirë drejtpërdrejtë. Këta të fundit "në të mirë" të kësaj nisme publikojnë vazhdimisht materiale arkivore, që trajtohen si e vërteta përfundimtare rreth një ngjarje të caktuar. Por a mjafton kaq? Çfarë ndodh realisht me një dosje? Si sigurohen këto materiale që publikohen? A duhet lexuesi t'i marrë, si të mirëqena plotësisht? Përse më të kritikuarit për krimet e komunizmit janë artistët dhe shkrimtarët? Cila është puna që duhet të bëjnë historianët për ...



100 vjet arsim dhe kulturë në Dukagjin

NË RRUGËN E DIJES DHE TË KULTURËS



Nga Zef Bari

Shumë kohë përpara se shkolla në Dukagjin, të hidhte hapat e pare, dukagjinasi kane ëndërruar, jo vetëm për liri e pavarësi, por edhe për arsim dhe kulturë, si bazë e domosdoshme për përparimin e çdo kombi.

Të huajt që kanë vizituar trevën e Dukagjinit, në fillimet e shekullit të kaluar, por dhe më pare janë mahnitur, jo vetëm nga bukuria e maleve, e natyra me çdo përbërës të saj, por në veçanti me malësoret, që ishin bërë njësh me malet, pjesë e jetës së tyre, nevojë dhe domosdoshmëri për të mbijetuar, për të përballuar sfidat dhe padrejtësitë, e atyre që iu sulen për ti rrëmbyer lirinë, krenarinë e vlerat që e bënë të njohur e të vlerësuar në shekuj.

Të huajve u bënte përshtypje, inteligjenca dhe mënçuria e malësoreve, të cilët edhe të pa shkolle, ishin të sakte në lidhjen e ngjarjeve dhe të datave historike të krahinës dhe të kombit. Ishin njohës të sakte të ligjeve të kanunit, që për atë kohë ishte kushtetute e vetëqeverisjes së tyre, njohës dhe zbatues për kohen të kodit të familjes, të bashkëpunimit dhe të punës në grup, lahutarë që këndonin dhe mbanin mend me dhjetëra e qindra vargje, të eposit të kreshnikeve, arkitekthe të zot, në ndërtimin e kullave, aq të forta e funksionale e të vështira për kohën. Ishin të lidhur fort me familjen, atdheun e fenë. Këto dhe të tjera fakte tërëhoqën interesin e të huajve dhe të shqiptareve që të shkruajnë për Dukagjinin dhe dukagjinasi, si Edit Durham, Roza Alen, Nopça, Fishta, Siliqi e të tjerë

Hapat e pare të rëndësishëm u hollën që nga kurset e ngritura nga kisha, fondacione të veçanta që financuan të huajt, e pastaj kur filloi të ketë shtet, me buxhet e specialist duke u mbështetur në atë pak përvojë tonën e më shumë në ato forma dhe metoda të huaja të funksionimit dhe drejtimit të arsimit.

Mësuesve u është besuar në çdo kohë, kontributi, menaxhimi, e drejtimi i dëshirave, ëndrrave e vullneteve të brezave të rrejtë për dije, kulture dhe zhvillim. Thënia se, “Një libër një lapës, një fëmijë, një mësues mund, ndryshojnë botën”, ishte një motiv më shumë për mësuesit, që kanë punuar në kushte të vështira në veçanti në zonën e Du-

kagjinit. Mësuesi ishte, figure e respektuar e komunitetit, modeli i një njeriu të kulturuar me norma të larta shoqërore, i përgatitur nga ana profesionale, i përzgjedhur që herët për misionin dhe përgjegjësitë që do të ketë në të ardhmen, për edukimin e brezit të ri. Mirënjohje dhe respekt për të gjithë ata mësues që janë ndare nga kjo jetë, e për ata që gëzojnë vitet e pensionit dhe të tjerë që punojnë dhe sot, në edukimin dhe arsimimin e bijve e bijave të Dukagjinit.

Brezi im edhe pse jemi futur në zonën e moshës të tretë, e unë personalisht, kujtoj me respekt e nostalgji mësuesit e mi të arsimit 8 vjeçar që punuan në Theth, në fillimet e viteve 60-të të shekullit të kaluar. Punuan në atë kohë kur mungonte drita elektrike, mungonin elementet baze të informimit dhe të kushteve për të jetuar. Ata që na tregonin se çfarë kishte prapa maleve, sa gjere e gjate shtrihej qielli, si ndriçoheshin qytetet me drite elektrike, se bota ishte e madhe, me popuj e raca të ndryshme, se njerëzit lëvizin me makina, trena avionë e anije, se në do të mësojmë e do të bëhemi të ditur e të zot, që do të na njohe Shqipëria, duke na bërë të fluturonim me imagjinatën tonë, rrugëve e shtigjeve ku na çonte fjalla dhe këshilla e mësuesve tanë. E duke kujtuar disa prej tyre, si Tusha Jubani, Ndoc Grima, Kareman Ulqini, Aishe Karaj, Muhamet Shala, Tasim Mlloja, Vjollca Kaja, Saxhide Llukacaj, e shumë e shumë të tjerë, që qenë mësues të brezit tim, të cilët kane lënë kujtime të pashlyera, tek ne dhe komunitetin e asaj kohe.

Që fëmijë unë fiksova modelin tim për të ardhmen, profesionin tim, atë që do të më shoqëronte në rini, do të rritesha, të piquesha, e të plaksha me te, me atë profesion që ma imponuan mësuesit e mi me shembullin e tyre para një gjysme shekull.

Në shtatorin e vitit 1973, provova emocionet e mia para nxënësve si mësues në Kodër Shëngjergj, në Lotaj. I ndodhur para atyre nxënësve, që sillnin çdo gjë nga ai komunitet, dëshirën për dije, sinqeritetin, respektin, bujarinë, krenarinë, por dhe varfërinë, e cila në atë kohë ishte e shtrire në çdo vatër, shihej dhe prekej kudo edhe pse Migjeni për mjerimin kishte shkruar 30 / 40 vite përpara kësaj kohe. Më priten me shumë dashuri ish mësuesit e asaj shkolle, Mhill Leka mësues me zemër të madhe, të gjithanshmin Pashko Cama, të urtin Gjergj Kroni dhe aktivistin e dalluar Fran Çardakun. Me Prek Vuksanin, shokun tim të bankës, të shkollës pedagogjike na kishin ndare sipas formulës të atëhershme, gjysmën e vitit shkollor në prodhim e gjysmën në shkollë

Për mua Lotajt janë qershia mbi torte për zonën e Shalës, por dhe më gjerë, jo sepse unë aty u njoha me burra të urtë, fisnike dhe bujare në shpirt dhe treves, të qeftit e shpotarë të thekun, por dhe një fshat që bashkëpunonin, ndihmonin dhe respektonin njeri - tjetrin. Aty mësova se fisi i Shalës, nuk kishte histori, kuvend,

pleqëri, kushtrim, mërzi apo gëzim, pa kontributin e burrave të Lotajve.

E kam dashur dhe e dua traditën e mirë, historinë, kulturën, e në veçanti folklorin dhe etnografinë e zonës time. Kam shkruar dhe ruaj me dhjetëra e qindra vargje të krijuara, por akoma të pa botuara, që janë kënduar nga këngëtare amatore të fshatrave ku unë kam punuar, që nga Lotajt, Gimaj, Theth e tjerë. Veprimtaritë kulturore dhe artistike në shkolla, në fshatra e më gjere, i organizonin dhe i drejtonin mësuesit. Në këto veprimtari, që ishin të shumta, kam kontribuar dhe jam angazhuar, duke u ndjere shumë komod mes këngëtaresh, instrumentistesh, krijuesish e interpretuesish me plot, dëshirë por edhe art në forme dhe përmbajtje.

Kujtoj me respekt ngjitjen në skenë të tre breza të një familje ma lahute Dede, Fran e Zef Gjelloshi (Shullani me grupin artistik të Lotajve në pranverën e vitit 1974. Ose interpretimin po me lahute të katër lahutarëve nga Gimajt, që mbanin të njëjtin emër, Kolë. Këta ishin gati në një vije të drejte por me largësi të konsideruar nga njeri - tjetri me shtëpitë ku ata banonin, Kole Gjoni në Kaprrë, Kole Deda në Gag, Kolë Dema në Marvataj dhe Kole Bala i marvataj, por me banim afër qytetit të Dakajve.

Ende edhe sot pas afro dyzet vitesh sikur l dëgjoj zërat plot pasion, ritëm e melodi të këngëtareve të fshatit Gimaj, e në veçanti të ish nxënësve të mi, të cilët përveçse ishin të dalluar në mësim, veçoheshin dhe në veprimtari që organizonte shkolla, fshati dhe zona, si File Biga, Ndosh Nreshaj, Gjyste Logu, Frrok Malaj, Ndue Njemza, Ded Kerrci e tjerë.

Detyra e mësuesit jo vetëm si mësimdhënës, por dhe veprimtar shoqëror ishte i domosdoshëm. Mësuesi ishte studiues, evidentues, krijues, interpretues dhe ruajtës të vlerave më të mira të trashëguara nga të parët tanë. Ata janë bazë dhe argument, me objekte dhe dëshmi të shkruara për brezat që do të vijnë. Shkolla ishte vatra ku rriteshin dhe merrnin rrugën e artit talentet, krijuesit dhe interpretuesit e rinj.

Kujtoj me respekt dhe mirënjohje ish koleget e mi që qenë veprimtari të dalluar në shkollë, por dhe në bashkësi si, Fran Beka, Prel Bregu, Gjyste Shyti, Pal Bregu, Pashko Cama, Gjok Rrahi e tjerë, që ndihmuan dhe kontribuan në zhvillimin e kulturës në krahinën e Shalës, por dhe në krahinat e tjera ku ata kanë punuar. Mësuesi është si një qiri. Ai konsumon veten, për të ndriçuar rrugën të tjerëve.

Një shekull arsim në Dukagjin, është një rrugë e gjatë mes vështirësish dhe përpjekjesh, nga mësuesit shumë të përkushtuar, gjatë kësaj periudhe, por dhe nga malësorët e kësaj treve, që qenë të etur për dije, arsim e kulturë. Genin e dëshirës dhe të inteligjencës, për shkence, art e kulturë, bijtë dhe bijat e Dukagjinit, po e shpalosin edhe sot në bankat e shkollave, auditorët e

universiteteve, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropë, Amerikë dhe më gjerë. Shkolla dhe edukimi në çdo kohë ka qenë lëvizja nga errësira në dritë. Shkolla dhe libri, janë arma e tërë mençurit, të ecurit janë e ardhmja e çdo kombi. Shqipëria ka nevojë për njerëz të ditur, të aftë të çojnë përpara zhvillimin ekonomik e shoqëror të këtij vendi, duke i shtuar shpresat për të ardhmen, për tu integruar përkrah popujve e kombeve të zhvilluara të Evropës.



PËR MËSUESIN TIM TË PARË, VIKTOR KIÇI

Ai na mësonte
Ai na donte
Na jepte dritën për të parë!
Mësuesi ynë i parë!

Ai sakrifikoi,
ia filloi nga hiçi
Ai ishte mësuesi ynë
Viktor Kiçi!

Na jepte dije
Na jepte dashuri
Ishte zemërgjërë
Ishte Njeri!

Ishte shpirt i mirësisë
Kishte ideale
Përhapë pa pushim
Dritën në male

Të gjithë e donin
pleqtë dhe rinia
Respekt për të
kishte vegjëlia

Kudo që ti shkove
Të mirën fjalë fole
Dhe emrin e mirë
Ngado ti e e mbolle

Ndaj e donin prindërit
E donin fëmija
“Tungjatjeta Mësues”
E përshëndeste Malësia!

Poezi nga Ndue Mici

Shkrimtarët, shënjestra e lakmuar e Sigurimit të Shtetit

Shkrimtari dhe publicisti Stani është një ndër nismëtarët e parë, që ka firmosur hapjen e dosjeve në Shqipëri. Sot pas 27 vitesh ai e konsideron këtë proces të vonuar. Ndërsa, mendon se historianët duhet të bëjnë më shumë për të zbardhur të vërtetën e frikshme të diktaturës, pa u përpëlitur midis dogmatizmave dhe presioneve politike

Valeria Dedaj,

Procesi i hapjes së dosjeve është një ndër nismat më të diskutuara në Shqipëri. Por, çuditërisht ky proces, nuk është aq fort i diskutuar nga viktimat, të cilët duhet të kërkojnë të njohin xhelatët e tyre, sesa nga individë që nuk janë të papërfshirë drejtpërdrejtë. Këta të fundit “në të mirë” të kësaj nisme publikojnë vazhdimisht materiale arkivore, që trajtohen si e vërteta përfundimtare rreth një ngjarje të caktuar. Por a mjafton kaq? Çfarë ndodh realisht me një dosje? Si sigurohen këto materiale që publikohen? A duhet lexuesi t’i marrë, si të mirëqena plotësisht? Përse më të kritikuarit për krimet e komunizmit janë artistët dhe shkrimtarët? Cila është puna që duhet të bëjnë historianët për hapjen e tyre etj., janë vetëm disa çështjet, që shkrimtari dhe publicisti Lazër Stani trajton në këtë intervistë për gazetën “Shekulli”.

Zoti Stani, fillimisht do donim të dinim se cili është mendimi juaj për hapjen e dosjeve në Shqipëri?


Hapja e dosjeve të ish- policisë sekrete të diktaturës, Sigurimit, është një proces i vonuar, i zvarritur në kohë, aq sa duket se nuk do të ndodhë kurrë, ose edhe në ndodhtë, do të jetë i pjesshëm, periferik, aq më tepër që arkivat, siç thuhet, janë abuzuar, dëmtuar, keqruajtur, me qëllimin e vetëm që të fshihet e shkuara kriminale, monstruoze të një regjimi shtypës, vrasës, i pamëshirshëm, çnjerëzor. Kam qenë nga të parët që kam firmosur një peticion së bashku me Visar Zhitin dhe intelektualë të tjerë ku kërkohej hapja e dosjeve që në vitet nëntëdhjetë, ashtu siç u veprua në disa nga vendet e Lindjes ish- komuniste, si në Gjermaninë Lindore, Çekoslovakia, Poloni, Hungari etj., por rezistenca për moshapjen e dosjeve ishte shumë e madhe, gjithmonë shpikeshin argumente të ndryshëm për t’i mbajtur të kyçura këto dosje. Shkurt; mungonte vullneti për hapjen e dosjeve, sepse në të vërtetë mungonte vullneti për t’u ndarë njëherë e mirë nga e shkuara diktatoriale.

Në dy momente vendimtare të historisë tonë, ne na ka munguar guximi si popull të shpëputemi përfundimisht nga e shkuara: pas shpëputjes nga Perandoria e rrënuar Osmane, ne u përpëlitëm shumë vite midis të shkuarës dhe projektit të së ardhmes evropiane të kombit shqiptar. Njëjtë u sollëm edhe pas përmbyesjes së diktaturës. Na mungoi guximi të shpëputemi një herë e mirë nga diktatura, ndaj gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit përpëlitëm midis të shkuarës dik-

tatoriale dhe të ardhmes demokratike, duke u sunduar nga diktatorë të vegjël, që sillen e veprojnë si pashallarë, politikisht të dëmshëm dhe qesharakë në përmbajtje. Pikërisht për këtë mendoj se hapja e dosjeve është një hap i rëndësishëm për shpëputjen nga e shkuara. Ne duhet të kemi aq guxim si shoqëri sa t’i thërrasim gjerat me emrin e vet: të zezës t’i themi e zezë dhe të bardhës e bardhë.

Duket sikur procesi i hapjes së tyre (dosjeve) është kthyer në mision në vet-vete, edhe kjo jo aq shumë nga viktimat, që kërkojnë të njohin xhelatët e tyre, por nga individë të caktuar (të papërfshirë drejtpërsëdrejti), të cilët publikimin e materialeve arkivore, e konsiderojnë një arritje të madhe personale. Çfarë mund të na thoni ju rreth kësaj, mendoni se publikimi i materialeve arkivore të personazheve publikë mund të bëhet nga kushdo?

Nuk ka pasur deri tani hapje të dosjeve



Lazër Stani

të policisë sekrete. Janë publikuar dëshmi periferike, kryesisht, materiale të marra nga Arkiva e Shtetit, që nuk përbëjnë ndonjë sekret. Natyrisht mes tyre është botuar edhe ndonjë raport i përgatitur nga Sigurimi Shtetit për udhëheqjen e lartë të partisë, për individë, ngjarje apo fenomene të caktuara, që gjithsesi dëshmojnë aspekte të kriminale të diktaturës, absurdisht dhe marrëzinë e regjimit në të cilin kemi jetuar. Por gjithsesi kutia e zezë e dosjeve mbetet e pahapur.

Dokumentet janë fakte historike dhe historia si shkencë ka shumë për të bërë që të zbardhet gjithë e vërteta e frikshme e diktaturës. Por shkenca e historisë tek ne, për fat të keq, ende përpëlitet midis dogmatizmit dhe pasionit politik. Por si dogmatizmi, ashtu edhe pasioni politik, nuk të shpien tek e vërteta historike, përkundrazi të hallakatin; deformojnë dhe fshehin të vërtetën. Azem Shkreli, duke iu drejtuar poetëve shkruante vargjet: “Poetët duhet ta kenë një Perëndi/

dhe tjetër s’ka të vërtetën”. Historianët shqiptarë që kanë trajtuar periudhën e Luftës së Dytë dhe pasluftën, pra diktaturën, ende nuk e kanë zbuluar këtë perëndi, Perëndinë e Të Vërtetës, ndaj studimet e tyre dhe librat e botuar janë të dyshimtë. Mendoj se këtu nuk ka vend për protagonizëm, por për profesionalizëm, besnikëri ndaj fakteve historike dhe përkushtim ndaj të vërtetës.

Bie në sy, por materialet që bëhen publike kryesisht u përkasin artistëve, shkrimtarëve dhe rrallëherë individëve, që mund të kenë pasur funksione të rëndësishme shtetërore asokohe. Përse mendoni ju se ndodh kjo?

Është një histori e vjetër kjo, e pistë dhe e poshtë, që zë fill menjëherë pas shembjes së diktaturës. Arkitektët e dhunës dhe të regjimit diktatorial fërkonin duart, ndërsa shtypi mbushej me shkrime dhe akuza për shkrimtarët dhe artistët, sikur ata të na paskëshin qenë demonët e të keqes. Të dalë nga makthi i diktaturës edhe vetë shkrimtarët u bënë pjesë e kësaj loje të djallëzuar, u mobilizuan kundër njëri-tjetrit, u përfshinë në fushata poshtëruese, të nxitur edhe nga dobësitë e tyre si njerëz: smirat, zilitë, rivalitetet, armiqësitë e fshehta. Duke qenë emra publikë, shkrimtarët gjithnjë tërheqin vëmendjen, lexuesi gjithmonë është i etur të dijë sa më shumë rreth jetës së tyre. Dhe u arrit deri aty sa u krijua ideja krejtësisht e gabuar se diktaturën në Shqipëri e kanë ndërtuar dhe mbajtur në këmbë shkrimtarët dhe artistët, çka nuk është aspak e vërtetë. Vetë shkrimtarët dhe artistët kanë qenë shënjestra e lakmuar e Sigurimit të Shtetit, gjithmonë të përgjuar, gjithmonë të mbajtur nën mbikëqyrje, qoftë nga struktura të posaçme policeske, qoftë nga

aparatchikët dogmatikë partiakë, që mbronin me besnikëri vijën e partisë. Diktatura në Shqipëri zuri të instalohej me vrasje shkrimtarësh në hapat e parë të saj: Vinçens Prenushi dhe at Anton Harapi ishin viktimat e para të pafajshme. Janë me dhjetëra poetët, shkrimtarët dhe artistët e arrestuar, burgosur, ekzekutuar në vitet e diktaturës. Në vitet e para u burgosen emra të njohur, si Musine Kokalari, Arshi Pipa, Petro Marko, Kasem Trebeshina, Pjetër Arbnori, u vazhdua me Frederik Rreshpen e Visar Zhitin dhe me dhjetëra e dhjetëra të tjerë. Të tjerë poetë u ekzekutuan, si Trifon Xhagjika, Vilson Blloshmi, Genc Leka për ta mbyllur me varjen e një poeti në grahamat e fundit të diktaturës -Avzi Nelës.

Pra në ferrin e krijuar nga diktatura shkrimtarët dhe artistët ishin on target, por edhe brenda këtij ferri, poetë dhe shkrimtarë krijuan poezi dhe proza dinjitoze, që mbetën një thesar i rëndësishëm për kulturën shqiptare. Është e lehtë t’i

gjykosht sot në liri veprimet dhe sjelljet e njerëzve që jetonin me qafën në gërrshërë. Dhe, për fat të keq, ashtu kanë jetuar shkrimtarët dhe artistët shqiptarë, edhe ata që dukeshin të përkëdhelur nga Partia. Sigurisht, si në çdo komunitet tjetër, edhe këtu pati individë që u thyen nga presioni, apo bashkëpunuan vullnetarisht me organet e represionit, u bënë palë me sigurimin, direkt ose indirekt morën pjesë në krime. Hapja e dosjeve gjithsesi, do t’i japë fund një amoraliteti abuziv ku gjithkush mund të akuzojë gjithkënd. Dhe në fund dua të shtoj se zhvendosja e skenës së krimit nga bodrumet e errëta të policisë sekrete dhe zyrtat e zymta të zyrtarëve të lartë të shtetit komunist në tryezat e shkrimtarëve është një orkestrim djallëzor për të fshehur të vërtetën e krimeve të komunizmit në Shqipëri dhe një alibi që eksponentët e diktaturës i bëjnë të shkuarës së vet.

A mendoni se këto materiale duhet, që të studiohen imtësisht nga studiuesit e fushës dhe historianët para publikimit të tyre? Dhe a mendoni se kemi ne njerëz, që janë të përgatitur për këtë proces në vendin tonë?

Mendoj se nuk duhet të ketë më censurë, abuzim me sekretin që sjell fshehjen e të vërtetës. E vërteta, cilado qoftë ajo, sado e dhimbshme dhe e frikshme, do ta çlirojë shoqërinë nga ankthi, i shërbën shëndoshjes së saj, rikthimit të kodet dhe vlerat morale, pa të cilat nuk ka kuptim një shoqëri njerëzore dhe ku ne kemi humbur vërtetë shumë. Ende dyshoj se kemi elita shkencore, që mund të bëjnë ekspertizën, duke iu bindur vetëm ligjeve të shkencës, tërësisht të pavarur nga ndikimi i politikës, aq më të për që jeta tek ne dhe karriera e secilit individ është e varur prej politikës me një mijë fije të dukshme dhe të padukshme. Por gjithsesi diçka mund të bëhet sidomos nga gjenerata, që nuk është e mpleksur drejt për drejt me diktaturën, me shërbime të kryera ndaj saj.

Një shoqëri që nuk ndëshkon krimin, vazhdon të mbetet një shoqëri e kriminalizuar

Procesi i hapjes së dosjeve po trajtohet si ndarje me të shkuarën. Mendoni se, kjo gjë do të ndikojë tek individët e përfshirë vetëm moralisht, apo do të ketë impakt edhe në historinë e periudhës komuniste?

Nuk shikoj ndonjë përpjekje serioze për t’u ndarë me të shkuarën. Asnjëherë në këto vite nuk ka pasur një përpjekje të tillë, ngaqë pushtetet politike të pas nëntëdhjetës janë ushqyer nga rrënjë të ngulitura thellë në të shkuarën diktatoriale. Duket sikur edhe ligji për hapjen e dosjeve më shumë është bërë nën presionin ndërkombëtar, se sa nga vullneti i brendshëm për hapjen e dosjeve, ndaj dhe gjithçka zvarritet pafundësisht. Lus-tracioni që nuk u bë kurrë, krijoi mundësinë që individë të inkriminuar, eksponentë

vijon në faqen 7

“POETI I VIZATUAR NË SHPIRTIN E GRUAS SË TIJ”

GJERGJ JOZEF KOLA DHE RITA NDOCI VENË SKENË NJË DRAMË PËR MARTIN CAMAJN

Petët kanë vetëm datëlindje, poezia i bënë ata të pa vdekshëm. I tillë është Martin Camaj, i gjithmonshëm, Camaj universal, Camaj i të gjithëve, Camaj i ynë, Camaj dhimbja dhe dashura jonë! I larguar vetëm fizikisht nga kjo botë ndër-sa poezia e tij rrjedhë si lumë i kristaltë vegimtar me të gjitha mjetet stilistike e estetike. I vlerësuar nga kritika si lirik i ndjeshëm tej mase ndaj motiveve të vendlindjes e fëmijërisë ai gjithë poezinë e tij përpiket të universalizojë me elementet thellësisht shqiptare. Bash në Kryeqytetin e Bavarisë, aty ku Camaj i pari akademik shqiptarë ofro gjysmë shekulli me parë themeloi Katedrën e Albanologjisë, pikërisht në ditën fatlume të lindjes së poetit të shkëlqyeshëm në një sallë të mbushur me adhurues te poezisë, artit dhe kulturës u bë promovimi i dramës “Poeti i vizatuar në shpirtin e gruas së tij”, të autorit të mirënjohur shkodoranë Gjergj Jozef Kola. Lum ai qytet që i nderon poetet e vet kudo qe te jene ata ne bote, ky qytet ka gjithmonë te ardhme! Kjo është sentenca proverbiale, që ka zgjedhur autori të publikojë në statusin e tij, i ngazëllyer pas shfaqjes së suksesshme të dramës së tij, e cila tek publiku solli përjetime emocionuese, ndjesi të fuqishme, gaz, lot malli, dhe duaj duartrokitesh bujare. Ky lumnim i

pianos së virtuozi, Besar Mitku.

Drama përbehet nga katër akte fund e krye nga dy personazhe Martinin (Poeti) dhe Lulja. konceptuar si monolog në dy veta here i Martinit me Lulen, herë i Lules me Martinin. Drama një analizës psikologjike të ndjenjave universale dashurore, e cila përcoll në dy gjuhë shqip dhe gjermanisht, I arratisur natën sterrë me trokun Pegazit fluturues poeti në mënyrë rastësore atje larg gjen lulen e jetës. Poeti vjen nga një dhe shkronjë i vogël e vjetër sa Evropa. Lulja një muzë me flatra e një ultësire të gjerë e dominues në Evropën flokëthinjur. Autori ka gërshtuar mjeshtërisht këto dy të kundërta funksionale prej të cilave lindi një binom jete si një flad i këndshëm shqiptaro-bavarez, që vijon akoma edhe sot 24 vjet pas vdekjes natyrale të poetit Camaj jeton në një botë të begatë e të lirë, por nuk i bën dobi kur atdheu i tij nuk ka liri. Ai këndon, por as kush këngën. nuk ja dëgjon, veç lules së tij, e cila e ngushëllon duke i thënë: - Profetët dhe poetet me se fundi pranohen në vendet e tyre. Martin ti je poet i lindur, ti na solle këtu Shqipërinë, i cila mos sot nesër, mos në të gjallë në të vdekur do të çmojë e vlerësoi si krenari kombëtare. Poeti e dëshironte shumë lexuesin të hynte në kontakt, të shkëmbente mendime, të

spektatorëve një karakter të realizuar artistikisht. Solli Lulen gjermane që kundërmonete, poetit aromën e gjithë luleve shqiptare. Rita na prezantoi një lule, që poeti i fali gjithçka, dashuri të virtytshme, fisnike, mjaltoje dhe të pa vdekshme në shpirtat e tyre engjëllorë. Në rreshtin e pare te Sallës dy buzë që dridheshin, dy sy të mbushur me lot malli vëzhgonin me përjetim të thellë Ritën në çdo lëvizje e fjalë që nxirre nga goja. Ishte Erika Camaj xhentile e pa plakur shpirti i së cilës që çdo ditë jeton me shpirtin amshuar të poetit të saj që bëri gjermankën lule bore Shkodre. Përmbyllja i monologut të Lulës me këngën Lule Bore solli ovacion të ngrohta ku e gjithë salla në mënyrë të natyrshme u ngrit në këmbë duke kënduar refrenin liturgjik shkodorane. Jonet këngës luleborë dhe lotët e mallit të reflektuar si ylber në atë mbrëmje të pa përsëritshme. Veprimtaria u realizua me anëtarë te Shoqatës e Klubit letrar “Martin Camaj”. Të ftuar nderi ishin edhe Përfaqësuesit e Konsullatave tona në Mynih, z. Arten Hanku, z. Hamdi Reqica dhe z. Dashi Ibra. Kolorin dhe shkëlqimin kësaj shfaqjeje ia shtuan në mënyrë të veçantë edhe fotot impresionuese plot armë Shqipërie të sjelle enkas nga vendlindja e poetit, nëpërmjet fotografes, profesionale Leonora Milani e ftuara e posaçme e këtij event. E ndërsa

Lanksch. Ky burrë më thinja fisnike, i qeshur, i thjeshtë, i respektuar. fliste një shqipe korrekte, njohës me detaje i veprës së Camaj dhe letërsisë së vërtetë shqiptare. I pyetur posaçërisht nga ana ime, se e vlerësonte Camaj me qetësi dhe përpikëri tipike gjermane më tha; - Ai ishte misteri i një poeti që u bë, si të thuash, shprehësi i gjallë i botes shpirtërore shqiptare në tokën gjermane. Ai u bë instanca më e lartë e shprehjes se gegnishtes sepse gegnishtja më arrirë është gjuha e kolosit të poezisë së Martin Camajt. Integriteti i tij e ruante nga çdo kompromis në punët e artit, e ruante nga cektësia dhe gjuetia për çmime e suksese. Ai urrente fjalët e mëdha (siç thoshte) gjestet e mëdha. Termini fama, ishte i pajtueshëm me shkrimtarin-njeriun Martin Camaj, ai dëshironte vetëm që të lexoheshin veprat e tij dhe të kishte kontakt me lexuesin Libri “Njeriu me vete e me të tjerë” titulli origjinalit shprehë dëshirën dhe nevojën e Camajt kur rinte në vetmi. D.m.th i tërhequr vetëm, ai shkruante, meditonte, filozofonte, por që kishte nevojë edhe për të kaluar kohen me njerëz të tjerë të shkëmbente mendime dhe të bashkëbisedonte. Profesor Lanksch ishte tepër i ndjeshëm që gegnishtja trajtohet vetëm si dialekt dytësor, jashtë dyerve të shkollave edhe kur shkruhet është me plot gabime pasi



Majtas, Leonora Milani dhe shoqja e saj, Lindita Haxhiu – Zeqiri



Profesor HANS-JOACHIM LANKSCH me Prele Milanin



Aktorja e këngëtarja Rita Ndoci me autorin e dramës Gjergj Jozef Kola



Dr. Erika Camaj, bashkëshortja e Martin Camajt

përket së pari Shkodrës qe lindi, Mynihut që e stolisi e lartësoi si qytetarë i botës, Prishtinës, Tiranës, Shkupit, Kozences, Ulqinit e vise mbare shqiptare nga ku u mblodhën shtegtaret e dashuruar të poezisë në datëlindjen e poetit shpirti i pavdekshëm i të cilit, fluturon në zemrat kombit të tij te pa vdekshëm.

Me 23 korri fluturoi një dallëndyshe e begatë e cila solli në qellin Mynihu një aromë mikse shqiptare - gjermane. Premiera e dramës “Peti i Vizatuar në Shpirtin e gruas së tij” erdhi me regji dhe interpretimin e virtuozi te Artistes se talentuar, Rita Ndoci, autorit dhe aktorit Gjergj Jozef Kola. Vepra është një dramë e mirë shkruar me një gegnishte kundruese, që syzon një subjekt interesant, të mirë ideuar, shoqëruar nen tingujt e

bashkëbisedonte dhe të filozofonte me të. Dhe pikërisht aty në atë vend ku as kush nuk e njihte se nga vinte dhe kujt përkiste, përmes poezisë së tij esenciale hyri në analet e letërsisë së këtij vendi me kulturë galaktike. Shtegtari i përvuajtur i poezisë i larguar nga Temali i Dukagjinit pa pasuri tjetër veç një torbë mbolli dhe lartësoi emrin e Shqipërisë në tokën bavareze. Ligjëratë pas ligjëratë

Monolog pas monologu drama kristalizoi idenë se, lumturia nuk është vetëm të dashurosh dhe thjesht të jesh i dashuruar, por të jesh i dashuruar me të njëjtën forcë që dashuron.

Aktorja që i mungon shumë skenës shqiptare, Rita Ndoci e hijshme e freskët e zgjuar dhe plot temperament interpretoi jo vetëm me pasion, por solli përpara

e shkathte dhe fluturake, Lindita Haxhiu Zeqiri ishte kujdesur për çdo detaj të kësaj mbrëmje te veçantë vlerash! E cila vijoi gjatë në një tryeze mbarëshqiptare me prezantime, njohje e biseda mes miqsh të vjetër dhe të ri i shoqëruar me muzikë e shampanjë. Ra në sy mos prezenca dhe mungesa totale e interesimit nga Ministria e Kulturës së Shqipërisë, ku Camaj shihet akoma si djali i njerëks.

HANS-JOACHIM LANKSCH PROPOZON (Gramatikën e gunishtes letrare Martin Camajt)

Ishte një nderë dhe vlerësim pjesëmarrja në këtë event e studiuesit të shquar të kulturës shqiptare, njëherësh prezantuesit dhe kumtuesit të veprës së Martin Camajt, Profesor Hans-Joachim

shkruhet ashtu siç flitet pa rregulla gramatikore. Unë jam shprehur edhe me pare në shtyp dhe rrjetet sociale se - Ekziston dorëshkrimi i manualit të Martin Camajt, “Albanian Grammar”. Dorëshkrimi ruhet si dhe trashëgimia e tij letrare në arkivin letrar të Mynihut, znj. Erika Camaj e ka të fotokopjuar, Dorëshkrimi i Martin Camajt asht shkruar në shqip dhe pjesërisht në gjermanisht. “Albanian Grammar” përmban edhe leksione me ushtrime për përdorues anglishtfolës që duan ta mësojnë shqipen, edhe pjesë gramatikore. Unë kam mirësinë të propozoj me nxjerrë pjesët (shpjegimet) gramatikore, tabelat gramatikore si dhe tekste këndimi. Pjesë përbërëse gjermanisht mund të përkthehen shqip (gegnisht) e kështu krijohet një gramatikë e gegnishtes

EKONOMIA E MBYLLUR NATYRORE JETON EDHE NË KOHËT MODERNE



Malësia gjatë periudhës së sistemit feudal, pati një ekonomi tejet të rënduar, e cila zgjati deri në kohet moderne pa e njohur pothuajse kurrë sistemin borgjez, por mbeti e përfshirë në një EKONOMI TË MBYDHUR NATYRORE deri në vitet e pas çlirimit për t' mos thënë edhe më gjatë megjithëse elektrifikimi dhe arsimimi sollën qasjen moderne në Malësi.

Po çfarë ishte ky sistem ekonomik?

Ky sistem ekonomik në vetvete përfshinte atë mënyrë jetese ku të gjitha nevojat ekonomike e jetike siguroheshin nga puna dhe prodhimi vetjak familjare si ushqimet, veshmbathjet, enët e kuzhinës, veglat e punës, mbarëvajtja e bujqësisë dhe mbarëshkrimi i blegtorisë. Për të pasqyruar këtë realitet do nevojiteshin fare pak foto për ta kuptuar se sa e vështirë dhe e renduar ishte ajo jetesë, që fare mirë mund ta quajmë një mbijetesë sa për të mbajtur frymën gjallë. Një realitet i tillë pasqyrohet edhe në këtë foto, ku mjafton ta shohin moshat madhore mbi 40 vjeç dhe do ju rifreskohet në memorie koha e fëmijërisë.

Në këto foto vihen re shumë elemente kulturore, të cilët i përkasin një pune artizanale të punuara nga vete pjesëtarët e familjes, të cilat shërbenin kryesisht për përdorim vetjak si enë kuzhine, vegla pune, aspekte arkitekturore e deri te mënyra e jetesës.

Ajo që e rëndonte më shumë atë sistem ishte taksa e rëndë e feudalit, e cila shihej si detyrim ligjor, prej të cilit jo pak familje detyroheshin të shpërngulshi pasi për të paguar këtë takse humbisnin pronat dhe gjene e gjalle, pa llogaritur taksen e shtetit apo të sundimtarit.



Të flasësh për atë sistem duket sikur i referohemi mesjetës pa llogaritur se sa prezent është ky fenomen edhe në ditët e sotme sidomos në shtresat e ulëta të shoqërisë apo në zonat e thella malore, të cilat jetojnë në gjendje teje të mjerueshme duke

luftuar me realitetin për të siguruar sadopak nevojat minimale biologjike, e për t'i mbijetuar ditës së sotme, me shpresën për një mundësi më të mirë nesër.

Megjithatë malësoret kudo ku janë dinë ti mbijetojnë kësaj lufte jetike,



madje krenohen edhe me ato pak mundësi që jeta ka servirur për ta, duke pranuar me bindje thënien e moçme, "Ça t'na japin Zoti po gëzojmë n' këtë jetë".

Përgatitur nga Rita Shkurtaj

letrare moderne që mundet me shërbye si bazë për gegnishtën letrare.

PËR NDER TË MARTIN CAMAJT RITA NDOCI SHTRON NJË DARKË BUJARE DUKAGJINASE

Rita Ndocit sipas perceptimit tim, ora e moshës i kishte mbetur në vend në vitin 1990. Pas asaj premiere xixëlluese shoqëruar, me biseda, të larmishme, autografe dhe shkëmbim librash mes autorësh, fiksim momentesh me aparate fotografik ndiheshim shumë të përbushur. Dalë nga dalë pjesa me madhe e të ftuarve u larguan dhe spontanisht mbetëm kryesisht ne njerëz e shtëpisë (shkodranët). Qëndrimi me gjatë dhe vijimi i më tejshëm i një darke bujare nuk ishte nevojë e diktuar nga stomaku, por nga shpirti bujar i Rita Ndocit, që si gjithmonë e shkathet, gjithë thjeshtësi e hu-

mor na vuri para një fakti të kryer. " - Sha Zotin" në paçi ardhë prej Shoshi me na e respektue për ma të madhin shqiptare që ka jetue në tokën Gjermane nuk jena ka shpërndahena sonte pa e hangër bashke ka një kafshate buke me çfarë të na qëlloje. Mirë se erdhët e rini pa fije mërzi, si me kenë dikur motit te kulla Kolë Mark Nocit, në Palaj të Shoshit! Mu kujtua një thënie proverbiale e moçme sipas së cilës Ndera ma madhe ashtë me pa tjetrin direkt në sy e me i thanë me zemër - mirë se të ka pru Zoti!" Me këtë atmosferë gazmore u shtrua tervesa gjermane në një lokal special në qendër të Munyhut. Ndonëse e shumë mirë integruar në jetën gjermane, me familje solide, (bashkëshorti gjerman dhe Richard-it, fotokopje e nënës), Ritës i mungonte shumë Shkodra, skena dhe mikrofoni, prandaj i tha bashkëshortit sonte do flas pa doreza e çmallem vetëm me vëllezërit e mi. Dar-

ka filloi e vijoi gjatë me biseda, mbresa, kujtime të motit të shkuar, për Shkodrën, teatrin, këngën e humorin, shoqet, shokët, miqtë që e mbështetën, por dhe për smiraxhijtë që vazhdimisht i patën nxjerrë pengesat për të vijuar Institutin e Arteve apo për ngjitjen në skenë. Rita, pohon se kam vokacion të djathtë, por nuk paragjykoj as kënd, vlerësoj njeriun dhe testen. Shprehë mirënjohje për Zina Franën, ishte komuniste por zonjë gruaje, e cila e ka ndihmuar drejtësisht kur djallëzish i kujtonin kleçkat biografike. Ndiën nostalgji dhe keqardhja për dëbimin e Zonjës Topali nga politika. Folëm gjanë e gjatë për Palajt e Shoshit, vendlindjen e babës Kolë, për kushërirë të saj një zjarm, i Palë e Vat Mehilli dhe të ndjerin Mark, që e zuri makina (me të cilët unë kam dy breza kumbari). Pastaj rreshtuam si rrugat në vargun e gjatë të artistëve, shkrimtarëve, sportistëve dhe klerikëve

martir që Dukagjini i dha Shqipërisë. Folëm e folëm, qeshëm e u shkulëm së qeshuri nga batuta e Ritës dhe shoqes së e saj Silvi nga Shkodra, kushërire e Nikolin Thanës. Gjergj Jozef Kolës akoma nuk e kishin lëshuar emocionet e premierës, i cili herë pas herë shprehte indinjatën për mos pranimin nga Ministria e Kulturës, për të mos bërë asgjë për Camajn. Rita di të presë bujarisht dhe të krijojë atmosferë gazmore të veçantë. Aty për aty na dha këshillën, mos hani shpejt se këta gjermanet kur boshatisin sahanin, vijnë e të thonë ngrihu nga tavolina, pasi ata nuk kanë kohë me ndjetë gjatë si ne shqiptaret në tavolinë! Premierës mbresëlënëse "Peti i Vizatuar në Shpirtin e gruas së tij" regjisorja dhe aktorja Rita Ndoci me darkën bujare dukagjinase i vuri një kurorë me dafina në kokë siç e meritonte Martin Camaj ynë.

Prelë Millani

Faza e parë e përgatitjes së Konferencës shkencore, me temë: “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”

Një qind vjet më parë, pikërisht me datën 2 shkurt 1917, atdhetari At’ Shtjefen Gjeçovi, në fshatin e Thethit, pranë kishës, në Qelë, hapi shkollën shqipe, në të cilën djem e vajza të këtij fshati dukagjinasi filluan të shkruajnë e lexojnë shqip.

Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në bazë të planit të përgatitjes e zhvillimit të konferencës - shkencore, me temë: “100 vjet arsim e kulturë në Dukagjin”, Kryetari i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini: e Sekretari i kësaj shoqate, Luigj Shyti, në bashkëpunim me Administratorin e Njesisë, së Shalës, zotin Petrit Arra dhe kryeplakun e këtij fshatit turistik, te fshatit të Thethit, z. Marash Rrgalla, me datën 23 shtator 2017, në prezencën e disa banorëve të këtij fshati, vendosën pllakën përkujtimore, me mbishkrimin: “Këtu, At’ Shtjefen Gjeçovi, me 2 shkurt 1917 hapi shkollën shqipe”.

Pas një kafe nga Paulin Polia u nisëm për në Shkodër. Gjatë rrugës mjaft makina shkonin në Theth, që aq shumë dëshironin të shikonin bukuritë e mahnitshme të kësaj qendre të Alpeve Shqiptare.

Një qind vjet më parë, pikërisht, me datën 1 dhjetor 1917, pranë kishës së fshatit Plan, te Qela, atdhetari e gjuhëtari At’ Justin Rrota, hapi shkollën e pare shqipe. Në bazë programit të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, me datën 24 shtator 2017, në bashkëpunim me administratorin e Njesisë së Pultit, z. Tome Ndoka, kryeplaku i fshatit Plan, z. Pjeter Thani, grupi i Shoqatës i përbërë nga Ndue Sanaj, Luigj Shyti, Prele Shytani, Roza Pjetri e Gjovalin Kodra vunë në ballin e kishës së Planit, pllakën përkujtimore “Këtu. At’ Justin Rrota, me 1 dhjetor 2017 hapi shkollën shqipe”.

Në këtë ceremoni Ishin të pranishëm banorë të këtij fshati, në mes tyre Ndok Leka, Pal Thani, Leke Thani, Florenc Peshku, Mirash Kroni e të tjerë.

Ketë ceremoni e hapi Administratori i Njesisë së Pultit, z. Tom Ndoka, i cili në mes të tjerave theksoi: “Njësia Administrative Pult në bashkëpunim me Shoqatën Atdhetare “Dukagjini”, organizon këtë ceremoni në kuadrin e 100 vjetorit të hapjes së shkollës së parë shqipe, në Pult. Gjej rastin të përshëndes Shoqatën Atdhetare “Dukagjini” për këtë nisëm. Ajo ka bërë një punë shumë të madhe për hulumtimin dhe promovimin e vlerave më të mira që Dukagjini ka pasur në shekuj

dhe ka, që më së miri janë pasqyruar në gazetën “Dukagjini”.

Sot jemi mbledhur për të venë këtë pllakë përkujtimore këtu në kishën e Planit, ku 100 vjet më parë At’ Justin Rrota ka hapur shkollën e parë shqipe në Plan. Me dijeninë time, po në këtë vit është hapur shkolla shqipe edhe në fshatin Xhan nga Ipeshkvi At’ Benard Shllaku.

Ndihem krenar që Pulti, të cilin unë drejtoj ka dhënë kontribut kaq të shquar në arsim e kulturë.

Më pas, në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, përshëndeti të pranishmit, kryetari i Këshillit të Shoqatës, z. Prele Shytani, që në mes të tjerave u ndal: “Në kuadër të 100 vjetorit të arsimit në Dukagjin, Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në bashkëpunim me njësinë administrative Pult, organizon këtë veprimtari për të vënë pllakën përkujtimore ku brezat e sotëm dhe ata që vinë ta dinë se 100 vjet më parë dhe pikërisht, me 1 dhjetor 1917, At’ Justin Rrota, këtu në Plan hapi shkollën shqipe, në të cilën deri me 3 dhjetor u regjistruan 25 nxënës. Prandaj, në emër të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” përshëndes të pranishmit dhe gjithë popullin e fshatit Plan e Gjura për kontributin në sektorin e arsimit tash 1 (një) shekull.

Sigurisht që kjo shkollë nuk e pati jetën e gjatë dhe për 3 dekada, për arsye objektive e subjektive, pati një vakum në arsim. Pra, si në gjithë Dukagjinin më përjashtime të vogla, as këtu nuk pati shkollë. Vetëm në zbatim të reformës arsimore të vitit 1946, kur arsimit fillor u bë i detyrueshëm për fëmijët e moshës mbi 7 vjeç, krahas luftës kundër analfabetizmit, u hapën shkollat e para. Dhe pikërisht në vitin 1947, në Qeresh me mësues të parë Regjina Deda e Gaspër Markiqi, ku kishte 35 nxënës, kurse në Prëndrejaj, në shtëpinë e Kolë Prelës me mësues Shaban Matën, me 28 nxënës. Edhe në Kuje pat hap shkollë prifti Lazër Tom Sheldija, por që nuk vijoi gjatë. Në fillim fëmijët e Kujës bënë mësim në Prëndrejaj deri sa u bë ndërtesa e re në Kuje dhe nxënësit e bënë mësimin aty. Në Maja –Thanë u hap shkollë fillore në vitin shkollor 1970-71 në shtëpinë e Mark Lules, me mësues Mirash Bregun.

Kurse analfabetizëm ka pas në: Maja-Thanë, Qeresh, Boks, Prëndrejaj e Kuje deri në zhdukjen e tij, në vitin 1955 për të gjithë të moshës

nën 40 vjeç. Në kuadër të masivizimit të arsimit, qeveria e kohës bëri të detyrueshëm arsimin 8 vjeçar në të gjithë vendin. Kështu që, si kudo në Dukagjin, edhe në Plan u hap shkolla 8 vjeçare, në shtator 1968, vetëm klasë të pestë me 30 nxënës e mësues të parë Tef Topallin, shkollë e cila vijon edhe sot, por me nxënës shumë të reduktuar.

Kam pas fatin edhe unë të shërbej 3 vjet këtu duke përcjellë edhe kontingjentin e parë të kësaj shkolle që mbaruan klasën e tetë.

Për të lehtësuar frekuentimin e nxënësve të lagjeve të largëta, sidomos Kujës, po në vitin 1968 u hap konvikt në Plan, në shtëpinë e Gjon Markut, me kuzhinierë - kujdestare, fillimisht Marie Shytani, pastaj Drande Ze-fja. Për studimin e tyre, kujdeseshin mësuesit, të cilët ishin të gjithë të ardhur nga vende të tjera. Shpenzimet i mbulonte shteti dhe ekonomia bujqësore. Shumë nxënës vijuan shkollat e mesme dhe të larta, duke shkëlqyer në sektor të ndryshëm të jetës. Plan –Gjuraj i kanë dhënë vendit personalitete të shquara si në art, në kulturë, në sport, në ushtri deri në rangjet më të larta, në ekonomi, në finance, në arsim e shëndetësi. Duke qenë shumë arsimdashës, Plan -Gjuraj kanë nxjerrë shumë kadro të lartë sa e gjithë pjesa tjetër e Pultit e marrë së bashku, të cilët sot shërbejnë me devotshmëri në sektor të ndryshëm të jetës, që mund të përmendim: Gjovalin Kodra, Gjon Fierza, Lazër Stani, Pal Leraj, Gjini Koçeku, Ndue Stragu, Gjyste Shpati, Prënda Lisi, Pashko Ara, Prelë Qershia, Gjellosh Farka e të tjerë. Siç shihet në themelet e arsimit në Dukagjin, një gurë të rëndë ka vënë edhe Planin, dhe ndër vite kontributi i tij në arsim ka qenë i madh. 100 vjetori i arsimit në Dukagjin duhet të mobilizojnë të gjitha forcat fizike dhe intelektuale, sidomos strukturat e pushtetit vendor e qendror, për ta ngrit në një start më të lartë arsimin në përgjithësi e në Dukagjin në veçanti, si në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënësve në mënyrë që niveli i nxënësve të u përgjigjet kërkesave të kohës.

Edhe një herë urime e në veprimtari të tilla u takofshim përsëri, për të promovuar arritje dhe vlera.

Pas kësaj ceremonie të shkurtër, bujaria e Leke Thanit e Ndok Lekes nuk kanë të ndalur. Ata, në një shesh, në

afërsi të kishës, na shtruan një koktej të plote me pije tradicionale - raki, djathë, turshi e qepe, mbi të gjitha zemrën bujare të tyre, duke ruajtur një traditë të hershme të maleve tona, mikpritjen. Por, kjo pritje nuk do të kishte bukurinë e vet, pa fyellin, veglën tradicionale të muzikës popullore, karakteristike për malet tona, që i ra aq mirë Pal Thani. I lumtë!

I falënderojmë nga zemra! Paçin e dhënçin!

Po në këtë datë Grupi i mësipërm, në bashkëpunim me kryeplakun e fshatit Prekal, z. Marash Pjetri, rreth orës 16.30 vendosi pllakën përkujtimore në Qelën e Kishës, me mbishkrimin: “Këtu, At’ Shtjefen Gjeçovi, me 17 shtator hapi shkollën shqipe”, se në këtë fshat, në Qelën e kishës së këtij fshati, atdhetari At’ Shtjefen Gjeçovi, 100 vjet më parë, me 17 shtator 1917, hapi shkollën shqipe, në të cilën djem të e vajzat e këtij fshati filluan të shkruajnë e të lexojnë shqip.

U bënë foto dhe pas një kafe bujarie te z. Marash Pjetri, u nisëm për në Shkodër.

Pasi u ndamë me banorë të këtij fshati, me shumë dashuri e respekt, në bar – restorant “Zalli Kirit”, në Rosek, kryeplaku i fshatit Plan, z. Pjeter Thani, na shtroi një drekë - darke me shumë bujari. E urojmë me urimin popullor “Pjeter paç faqen e bardhe! Paç e dhënçi në gëzime!”

Kryesia e Shoqatës realizoi një nga veprimtaritë e saj të rëndësishme, për të evidentuar e përkujtuar punën e atyre fëmijëve, që me shumë përkushtim punuan që djemtë e vajzat dukagjinase të mësonin shkrim e këndim. Por, nuk na vjen mirë, që disa mësues të shkollës së Thethit, të shkollës së Planit dhe të shkollës së Prekal nuk ishin prezent edhe pse ishin njoftuar dhe ishin të njohur me këtë veprimtari të shoqatës. Gjithashtu nuk na vjen mirë që TV ROZAFa dhe TV ANTENA NORD nuk bënë përpjekje të ishin prezent e të publikonin këtë event të rëndësishëm të shkollës shqiptare në këto male.

Shpresojmë, se ky shqetësim i yni do të jetë në të ardhmen dhe shqetësimi i juaj!

Redaksia e gazetës



Në Prekal, për vendosjen e pllakës përkujtimore të hapjes së shkollës shqipe aty



Në Theth, për vendosjen e pllakës përkujtimore të hapjes së shkollës shqipe aty



Në Plan, për vendosjen e pllakës përkujtimore të hapjes së shkollës shqipe aty



vijon nga faqja 3

të shpallur apo të fshehtë të diktaturës të ruanin pushtetin e tyre, privilegjet e tyre. Gjithsesi hapja e dosjeve krijon mundësinë për të kuptuar më mirë ferrin në të cilin jetuan shqiptarët për pesë dekada dhe lehtëson punën e studiuesve që duan t'i bëjnë autopsinë diktaturës. Ky është një impakt pozitiv gjithsesi.

A mund të arrijnë shqiptarët, që edhe pas hapjes së dosjeve, të ndahen me të shkuarën, pa përsëritur të njëjtat gabime në formë tjetër, apo ideja e ndarjes me të shkuarën është thjesht propagandë politike? Dhe meritë personale do të thellohen më tepër?

Pak mëri dhe konflikte kemi prodhuar në këto vite, edhe pse dosjet nuk ishin të hapura? Bashkëjetesa me krimin e pandëshkuar, bashkëjetesa me të keqen krijon konflikte të vazhdueshme. Ndarja me të keqen, sjell shëndoshjen morale të shoqërisë, paqen shpirtërore dhe sociale. Vetëm eksponentët e sigurimit dhe të diktaturës janë përpjekur ta paraqesin hapjen e dosjeve si një minë me sahat, që do të shkatërronte vendin, thjesht dhe vetëm për të ruajtur lëkurën e vet faqe njerëzisë, ndërkohë që vazhdojnë

të mburren edhe sot e kësaj dite me bëmat e tyre të liga. Ata që e interpretojnë hapjen e dosjeve si një rrezik për konflikt social, mendoj se janë avokatë djallëzor të diktaturës dhe krimeve të saj, ku edhe vetë janë të implikuar në një mënyrë, ose në një tjetër. Unë asnjëherë nuk e kam parë një rrezik të tillë.

Gjatë dy viteve të fundit në vendin tonë hapur disa muzeume, në të cilat ekspozohen materiale arkivore (dosje), të cilat diktohen si të asaj periudhe. Por, a mendoni se mjaftojnë këto materiale të shkëputura rastësisht ose jo, të paplota për ngjarje të caktuara, që t'i mundësojnë siç duhet brezit të ri të njoh të vërtetën?

Janë nisma pozitive, por gjithsesi të pamjaftueshme. Brezi i ri, sipas të gjitha sondazheve të kryer, është pothuajse i painformuar për të shkuarën kriminale, për diktaturën.

Në dosjet përkatëse normalisht do të jetë emri i personave, që kanë spiunuar dhe që kanë firmosur në dosjet e sigurimit, si bashkëpunëtorë, qoftë edhe pa dëshirë. Por a mendoni se nëpërmjet hapjes së këtyre dosjeve, duhet të bëhen publike edhe emrat e rekrutuesve të spiunëve të sigurimit?

Është e vërtetë se shumë njerëz janë rekrutuar në kushte presioni të jashtëzakonshëm, janë bërë spiunë nën tryzni të tmerrshme, por ka dhe të tjerë që janë bërë bashkëpunëtorë për përfitime të ndryshme, ose thjesht, sepse ishin keqbërës. Diktatura mbështetej mbi të keqen, shfrytëzonte dobësitë dhe karakterin e keq njerëzor dhe kur këto nuk mjaftonin bënte presione dhe kërcënime monstruoze. Jo të gjithë ishin të fortë, të pathyeshëm. Por gjithsesi bashkëpunimi me të keqen është një akt i dënueshëm, pavarësisht rrethanave. Sigurisht, është normale që krahas emrave të spiunëve të bëheshin publike dhe emrat e rekrutuesve të tyre, por me sa duket nuk kanë për t'u mësuar ndonjëherë as të parët, as të dytët.

Ka shumë figura të njohura, që kanë qenë bërë dëme në atë periudhë (me imponim ose jo), ndërsa sot vazhdojnë të kenë funksione publike. Si duhet trajtuar kjo kategori? A duhet që të kërkojnë falje?

Falja nuk është e mjaftueshme, ndonëse me sa di askush nuk ka kërkuar falje deri më sot. Shkatërrimi i jetëve njerëzore nuk mund të kalohet me një: "Më fal". Është drejtësia ajo që duhet ta

thoshte fjalën e saj rast pas rasti. Në Ruman, vazhdojnë të dënohen nëpërmjet proceseve gjyqësore të rregullt eksponentë të diktaturës, që kanë kryer krime ndaj jetës së qytetarëve të pafajshëm. Në Shqipëri nuk di asnjë rast ku drejtësia të ketë vepruar. Dhe një shoqëri që nuk ndëshkon krimin, vazhdon të mbetet një shoqëri e kriminalizuar. Kjo, pak të thash, është e frikshme.

Dhe së fundmi, a e shihni të domosdoshme, që kjo periudhë e pandriqur me fakte nga historianët, duhet të jetë pjesë e kurrikulave arsimore?

Ka një paradoks të turpshëm: në tekstet e historisë të shkollave nëntëvjeçare u mësohet nxënësve me dy-tre faqe tekst industrializimi (shkatërrimi) socialist i vendit dhe vetëm me një paragraf diktatura dhe krimet e komunizmit. Në fakt vetëm vitin e fundit ka pasur një përpjekje për të informuar nxënësit e shkollave të mesme të Tiranës nëpërmjet leksioneve të hapura të organizuara nga Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Por kjo gjithsesi nuk është e mjaftueshme: tekstet e historisë që mësohen në shkollat tona duhen rishikuar.

Ulqini, një histori e vjetër ilire

Në çdo udhëtim të përshkruar është bërë zakon të prekim copëza përjetimesh të gjalla të natyrës, historinë e vendeve dhe kulturën e tyre të lashtë. Dendësia e përshtypjeve është aq e madhe saqë nuk di çfarë të shkruash më parë. Kështu ndodhi edhe në udhëtimin tonë drejt Ulqinit për të njohur këtë qytet të lashtë shqiptar me plot ngrohtësi e diell dhe me vlera të spikatura njerëzore, kulturore, historike e materiale. Edhe nëse e ke shkelur më parë dhe ke lexuar për historinë e tij, kur e viziton atë dhe trevat përfaqë, të befason përsëri natyra, arkitektura, deti, mikpritja gati proverbiale...

Megjithëse të përqendruar në rrugën me gjarpërimet e saj, panoramat e shumta, që parakalojnë përtej xhamave të autobusit, me sfond qielli e maja malesh shkëmbore, për ne ato reflektonin aq shumë pasuri natyrore. Autobusi vijon, herë kodrinave apo rrëzë tyre e herë luginave pjellore vende-vende me një rrezatim dendurie nga gjelbërimi, ku ndjehet aroma e frutave dhe fëshfërima e gjetheve të vjeshtës. Në hapësirat e sistemuara, si të qëndisura, të gëzon syrin pamja e vendbanimeve me shtëpitë që parakalojnë dhe si në një sfilatë mode, të dhurojnë pafundësi të tjera ndjesish.

Ulqini shquhet për historinë e vendbanimeve të lashta. Ngjitur tyre andej nga kalonte rruga të shfaqen tabela orientuese të vendeve me një të kaluar të largët historike. Shasi, qyteti antik i mbuluar nën rrënoja të trazon dhe vë në lëvizje mendimet tona me historinë dhe 365 kishat e tij.

Duke u përthithur në ca labirinte bisedash për udhëtimet në hapësirat shqiptare, ato mbështillen rreth motivimeve krijuese dhe takimeve me njerëzit e artit, kulturës e historisë sonë.

Bashkudhëtarja jonë nga Tirana, Luljeta Dano, poete dhe studiuese e njohur, flet me pasion për këto gjëra:

-E copëtuan kombin tonë dhe e ndanë në shtete të tjera. Ishin dhjetëra vite kur njerëzit e një gjaku dhe një gjuhe nuk mund të takoheshin, por tani erdhi koha t'i vizitojmë dhe të jemi të pranishëm në veprimtaritë e tyre, të lavdive tona të moçme në një mënyrë bashkëkohore, sepse kudo ku ndodhen trojet shqiptare, mund të udhëtojmë dhe të shijojmë trashëgiminë historike dhe shpirtërore.

Veçse ky udhëtim këtu krijon të tjera ndjesi kënaqësie për urtësinë dhe madhësinë ulqinake. Janë bisedat me miq të njohur dhe të rinj të këtij vendi që paraprijnë fjalët dhe u japin atyre të tjera përmasa.

Të prekësh Ulqinin

Të zhytur në ndjesitë e panoramave dhe bisedave mbresëlënëse, aty nga mesdita mbërritëm në Ulqin. Ashtu, me plot emocion, duke anashkaluar lodhjen, në orët në vijim shëtitëm qytetin. Ai shtrihet mbi ca bregore të gjelbërta dhe kalaja e lashtë buzë detit Adriatik me arkitekturën e veçantë të krijojnë ndjenja të papërsëritshme nderimi e respekti për banorët dhe për këtë trevë të njohur.

Ulqini është një nga qytetet turistike interesante të bregdetit Adriatik, i ash-

tuquajturi “qytet i historisë së bujshme”. Për të njohur më mirë në brendësi atë dhe rrethinat e tij, nga Ada e Krriçit deri në grykëderdhjen e Bunës, nuk mjafton një ditë.

Të mbetet në mendje peizazhi i papërsëritshëm i këtij qyteti. Kalojmë përmes qytetit në rrugët e potershme, që ngjajnë si në një panair me kolor përndritës. Limfa e turistëve dhe jona shkrihen në atmosferën e tij, duke e bërë të dukshme me ec e jakët karakteristike.



Ndërtimet në Ulqin kanë ruajtur të freskët vokacionin e kohëve të largëta me një urbanistikë tipike, një pjesë e të cilave u ngjiten kodrave. Aty bie në sy ndërthurja e tyre me ato moderne, sepse këtu ekziston mentaliteti pozitiv që e vjetra është relikte e duhet ruajtur. Vezullojnë reklamën e bar – kafeve, restoranteve, hoteleve dhe dyqaneve me punime artizanale, që të tundojnë për t'i blerë dhe t'i bësh pjesë të katalogut tënd.

Kronika e rrjedhës së jetës, ngjyrat e botës njerëzore dhe tabloja monumentale e tij janë imponuese, për t'u ndjerë i mrekulluar. Ndaj nuk mund të fshehësh kurrësi kënaqësinë frymëzuese kur je edhe buzë detit ulqinak. Mjafton të soditësh pak çaste ato mes atyre reflekseve magjike, që hedhin rrezet e diellit dhe qyteti të duket sikur luan vallen e kaltërsive të detit me përplasjen e dallgëve. Re të bardha si pambuk pikturojnë panoramën, kur era shtyn tufën e tyre dhe shfaq e largon copëza qielli. Ca biseda vijnë te ne me rrokje fjalësh e pasthirrma gëzimi të fëmijëve. Varka dhe skafe të ankoruara lëkundën lehtë nën melodinë e dallgëve. Pushues të rrallë e shfrytëzojnë mundësinë e këtyre ditëve të vjeshtës që të marrin jodin e tij. Klithma si miklime të pulëbardhave me fluturimin e tyre marrin vështirësinë tonë dhe shprushin emocion. Si një dëshmitar i këtyre çasteve, syri e shpirti, e ndjejnë të bukurën, hijeshinë, sidomos kur e prekin deri në rrënjë.

Në trokitje historike...

Faktet e përditësimit të kujtesës të bëjnë me dije dhe të nxisin kureshtjen për të depërtuar në terë dimensionin e së shkuarës ulqinake.

-Ulqinakët – thotë Nexhati, pronari i hotelit, ku bujtëm – shquhen për zejtarin, për këngë, për kultivimin e ullirit, ku gjen ekzemplarë 700 vjeçar, por më shumë ne jemi të njohur si detarë e tregtarë me të mirat materiale e jetike që përftonin, por edhe kusarë deti, që i sulmonin anijet

e venedikasve, dalmatëve, francezëve, e të tjerë. Qyteti ynë i bujshëm, me kalanë, si një trashëgimi e shekujve, gjithmonë ka qenë i lidhur me rrënjë të thella shpirtërore me udhët e “paudha” të detit nga piratët e vjetër të anijeve liburne aq emërmëdhenj në botën antike dhe mesjetare.

Por, në truallin e Ulqinit historia ka hipotekuar lashtësinë autentike, që mund të lexohet shumë qartë, ndonëse e mbuluar me eklipse e dallgëzime kohësh. Por,

po të hysh thellë në shekujt e tij, mëson shumë gjëra të reja. Herë duke u zmadhuar e herë duke u tkurrur, historiku i tij ka trashëguar mbishkrime, dorëshkrime dhe gjetje të hershmet që nga epoka e bronzit, edhe pse luftërat rrënuese ia kanë fshirë shumë gjurmë. Kur flasim për të gjitha këto, domosdo do të shkruajmë edhe për rrjedhat e jetës. Zanafillë e lidhur me periudhën plot labirinte të lashtësisë sonë ilire.

Këtu në këtë trevë të lashtë jetonin Ilirët e fisit të Labeatëve me madhështi emrash, kështjellash vendesh historike. Është kështjella që mbreti i tyre, Genti, e vizitonte herë pas here. Ndërsa Balshajt në Mesjetë e kishin selinë e tyre.

Historia e Ulqinit me psiko-hapësirat e zhurmshme të luftërave dhe shkatërrimeve ka mbështjellë misteret, fatet njerëzore, përplasjet, kurthet, brengat, pabesitë, mugëtira e moteve, zvenitjet dhe copëzimet e trojeve.

Në çdo kohë është lakmuar nga pabesitë e reve të zeza të stepave dhe erës së egërsuar përtej detit, e cila dhe përplaste me furi brigjeve të tij hieroglifë fjalësh të religjioneve. Kjo bëri që një pjesë e popullatës, duke i u përballuar stuhive të fuqishme të historisë, kanë qenë të shtrënguar t'i lëshojnë vatrat e tyre shekullore. Ky detyrim buroi edhe si pasojë e represionit sllav, që më së shumti kërkonte të zhdukte jetesën, pasurinë dhe vetë shqiptarët në këto troje si kudo ku banonin ata. Por, jeta që ka rrjedhur mes vështirësive, sërish ulqinakët e mbanin gjallë shpresën dhe rigjenin veten dhe forcën të mbijetojnë, duke i qëndruar me besnikëri të pashoqe kësaj toke të bekuar.

Kështjella e Ulqinit, jehonë lashtësie

Kështjella Ilire e Ulqinit, që ngrihet në një kodër shkëmbore buzë detit, madhështore për nga pamja, është por po aq arkaike nga simbolet më të cilat është dekoruar. Ajo kulmon si një dëshmi e gjallë arkitekturore dhe të flet me zërin e heshtur të historisë. Madje vlerësohet

si një ndër monumentet më të bukura të trashëgimisë kulturore, jo vetëm në Adriatik, por në gjithë Ballkanin. E ndërtuar në shekullin IV para erës sonë, tashmë është kthyer në një qendër historike e cila vizitohet çdo ditë nga turistë. Ajo është një muze i vërtetë i identitetit dhe kulturës ilire me histori edhe të periudhave të mëvonshme, të cilat nuk mungojnë dhje kanë rëndësi të veçantë.

Në kështjellë ngjitim, shëtisim e zbresin shkallët e kalldrëmta me pllaka guri shumëngjyrëshe, nën shoqërinë e mikpritësit tonë, Arbenit. Kështjella është e banueshme dhe gjithandej aty shtëpitë, bar -kafetë, restorantet, kompleksi muzeal, janë ndërtuar me gurë të skalitur me aq shumë mjeshtëri, çka u kanë dhënë atyre qëndrueshmëri të lartë. Është e natyrshme që këtu do të ndeshësh edhe gjurmët e kulturave turke, veneciane, etj, si pasojë e pushtimeve në kohëra me ndërtime fragmentare të ruajtura mirë.

Duke u endur nga njëri cep në tjetrin e ndjejmë thellë madhësinë e historisë dhe mëndja, përmes mjegullës së shekujve e lexon atë në muret e lashta. Kërkojmë mes morisë të gurëve ciklopik të kështjellës, Bindin e gdhendur, që i ngjan shqiponjës dhe e vështrojmë atë për një kohë të gjatë. Prej bedenave të saj mijëravjeçare, të shpëllara nga dallgët, por edhe në frëngjitë e portat e harkuara, të hapet si në një dritare të madhe sipërfaqja e detit me një shkëlqim marramendës. Që nga këtu në kohë me mot të kthjellët mund të shikohet Kepi i Rodonit, Kepi i Gjuhëzës, Ishulli i Sazanit dhe Gadishulli i Karaburunit.

Ciceronia e kështjellës, Zenepe Draga e hap udhën nëpër ndërtesat muze të zbardhëlluara. Thesaret arkeologjike të zbuluara këtu gjatë gërmimeve, por edhe ornamentet mitike të veshjeve popullore, armët luftarake, e të tjera, me objekte të llojeve të ndryshme, të ekspozuara në jo pak stenda, si vlera të mirëfillta tradicionale, shpalosen para nesh, të harmonizuara më së miri dhe të detajuara motive të jetës, thuajse të gjitha periudhat kohore.

Nëpër gjithë kompleksin muzeor, i plotëson njohjet tona mbi këtë qytet me aq histori, tradita e qytetërim të lashtë, shpjegimi në detaje i Zenepes, që për ne vizitorët është një gjë e rrallë dhe e çmuar. Me këtë rast ne u njohëm edhe me moketin e kalasë realizuar që në vitin 1956 nga punonjësit e saj dhe ringjalljen e ndërtesave mesjetare.

– Rreth kalasë ndërlidhen shumë histori, -të thotë Zenepja dhe, aq sa janë thurur për kalanë, aq edhe Ulqini është kthyer në një histori për kohën e largët dhe për ditët tona. Madje një nga historitë e shumta, e dokumentuar dhe shumë e njohur ka të bëjë edhe me Servantesin, shkrimtarin e njohur spanjoll, autorin e romanit “Don Kishoti i Mançes”. Servantesi ka qenë për disa kohë i burgosur në Ulqin. Për nder të atij vendi që e pëlqente shumë, të dashurës imagjinare të Don Kishotit, ia vuri emrin Dylqinjë, që rrjedh nga emri Ulqinj.

E shijojmë me kënaqësi një kafe në “Kullën e Balshajve” në kështjellë, një

kompleks interesant nga pikëpamja arkitekturore, ku modernia dhe antikja janë bashkuar më së miri në një harmoni të përkryer edhe elegancë.

Ne e vlerësojmë gjestin patriotik, të pashprehur me fjalë, për shqiptarin nga Kosova që e bleu këtë objekt. I bashkohet kësaj kënaqësie me bisedat e tij interesante Gazmend Kovaçi, zyrtari i kështjellës së Ulqinit. Me mençurinë e dashurisë së madhe për qytetin e tij të lashtë ai i sintetizon aq bindshëm kohërat historike, që vijnë në një zinxhir të pashkëputur nga ilirët, arbrit gjer te shqiptarët e sotëm.

– Ulqini – të thotë Gazmendi – ka histori të lashtë arkitekturore, dhe tregues të vlerave, që janë ruajtur me fanatizëm. Ndaj është në nderin tonë që të hershmen ta ruajmë e ripërtërijmë, sikurse është detyrë të nxjerrim nga thellësia e shekujve të vërteta të tjera historike. Dhe është fakt që këtu po punohet në këtë drejtim, që Kështjella e Ulqinit të pranohet në UNESCO, si objekt historik i një rëndësie të veçantë. Sepse kurrë nuk është vonë për të dhënë kontributin tonë, për të vendosur një gur të rëndë në murin e historisë. E shkuara qartësohet kur e di se nga ke ardhur për ta kthyer në vlerë për të gjithë.

Ndaj, studiues, historianë, arkeologë të Ulqinit gjithmonë kanë intensifikuar misionet e tyre hulumtuese, duke tejkaluar vështirësitë dhe meritojnë vlerësim për pasionin, atdhedashurinë dhe profesionalizmin.

Në këtë kontekst, kohët e fundit po larmojnë në formë dhe në trajta idesh, të spikatura në organizim veprimtarish studimore, që besoj se më shumë vlera do kenë kërkimet në vazhdimësinë iliro-arbërore-shqiptare të jetës tonë këtu, për të cilën historianët sllavë duan të na e ndryshojnë. Përveç ruajtjes së trashëgimisë kulturore- historike, pasqyrimi dhe afirmimi risjell filozofinë e vet, si pjesë e ndërtimit të etnitetit tonë.

Trashëgimia e kulturës pagane deri më tani ka mbetur larg syrit të studiuesve dhe turistëve të huaj, ashtu siç mendon studiuesi i ri ulqinak, Arben Berjashi, i cili mes të tjerash thekson: “... për të njohur dëshmitë arkeologjike, etnografike, etnologjike, etj, duhet ende shumë punë për të krijuar parakushtet e një pike të vizituar gjithnjë në rritje të trashëgimisë sonë”.

Ne, pranë mureve të kështjellës shekullore, ku oshtijnë dallgët e detit, që përplasen me jehonë shkëmbinje dhe të përgjuar me lashtësinë ndër sy, marrim udhën prej andej nga kemi ardhur.

Deti e përshpejton me pamjen dhe aromën depërtuese të tij rendjen tonë. Ndodh gjithmonë që kur largohemi nga një vend, mrekullitë që i shikojmë, i veshim si mantel mbi vete dhe i mbaritim ato kudo ku shikojmë, duke thënë: Ah të jemi përsëri aty, të fotografojmë të veçantën që të magjeps.

Sepse i tillë është Ulqini, vend që flet me gjithçka: me detin, kështjellën, diellin, ajrin dhe historinë e tij të rrallë shqiptare.

Nga **Pëllumb Gorrica**,
DITA, shtator 24, 2017

Mes “otoman-pansllavizmit lindor” e “nacional populizmit perëndimor”!



Nga Bes Bektashi

Sigurisht që pozita gjeografike e Shqipërisë është shumë e rëndë- sishme dhe e favorshme. Kjo pozitë gjeografike e daljes në Adriatik dhe Mesdhe, shërben në çdo kohë për llogari të mëdha ekonomike dhe kultural politike dhe deri në diktaturë, kjo pozitë ka shërbyer që regjimi i Hoxhës të shfrytëzonte pikërisht beneficet e një modeli mes lindjes dhe perëndimit?! Jemi i vetmi vend i ish “Traktatit të Varshavës” që kemi denoncuar këtë traktat dhe kemi dalë jashtë tij, pa ngrënë shpullat dhe pushtimin e “vëllezërve sovjetik” të asaj kohe?! Ishim vendi i vetëm që lejonte Kinën të lëvizte me flamurin tonë dhe të bënte tregti nganjëherë dhe kundër embargoeve në botë po me flamurin tonë dhe i vetmi vend, që kishin miqësi me Kinën e madhe të Mao Ce Dunit dhe të kohës së famshme me krime të “Revolucionit Proletar Kultural” për të prishur, kur kinezët u lidhën me amerikanët?! Jua kthyer dhe kinezëve, duke i bërë “tradhtarë dhe armiq dhe ata”, sigurisht mbasi na kishin ndihmuar mbasi prishjes me rusët. Por më përpara kishim bërë tradhtarë sigurisht përpara rusëve, edhe jugosllavët e Titos, që na kishin dhënë ndihmë për PKS-në?! Në fakt ishte pozita gjeografike e jona, por dhe Enver Hoxha si njeriu që “lundronte” mirë jo vetëm në sundim (diktatorship) të popullit të tij, por dhe situatës ndërkombëtare për mbi këtë territor të vogël dhe shumë të rëndësishëm gjeografik?! Sot ne kujtojmë se na kanë futur në NATO vetëm për popullin shqiptar? Sigurisht që po dhe miqtë tanë perëndimorë e kanë këtë projekt - por pozita tepër delikate dhe e rëndësishme gjeografike është e para që na bën nder kur vjen puna për përballje të erës perëndimore dhe asaj lindore - ku në mes sigurisht është Shqipëria! Sigurisht për gjeopolitikën e mëdha të USA dhe BE, por dhe vendeve të mëdha përfshi dhe Rusinë e Turqinë e para është pozita gjeografike e Shqipërisë, e dyta është popullsia dhe e treta - vetëm e treta është politika e këtij vendi?! Pozita gjeografike është ekstremi perëndimor i lindjes, pozita shoqërore dhe ideore e popullit është mentaliteti pjesërisht lindor ballkanik që dashuron perëndimin dhe kulturën e tij, dhe ajo politike sigurisht është perëndimore me brendi otomane në sjellje dhe veprime?! Tani plotësohen të

gjitha “kushtet” e rëndësisë së fjalës mes “lindjes dhe perëndimit”?! Mirëpo sot fryjnë dy erëra të forta dhe të ndryshme në territorin dhe sipërfaqen e këtij vendi të bekuar, por me njerëz sigurisht më pak të tillë! Nga lindja fryn era neotomaniste e Turqisë së Erdoganit, tashmë në sinkron të çuditshëm (por dhe jo aq shumë) me pansllavizmin putinist dhe nga perëndimi fryn era e fortë dhe shkatërrimtare e nacional populizmave perëndimore?! Sigurisht që këto erëra fryjnë dhe në saj të individëve në krye apo në krye të opozitave të këtyre shteteve të mëdha dhe të interesuar për ekspansionin si sllav të Rusisë, edhe neotoman të Turqisë?! Sigurisht janë vende të tilla që kanë brenda “sekretet” e mëdha si të trashëgimisë bizantine dhe osmane në luftë me njëra tjetrën, por dhe aleanca të vjetra me popujt e ndryshëm të perandorisë - kundra disa popujve dhe kombeve të tjera të saj. Turqit kanë luftuar me grekët ortodoksë, por kanë qenë bashkë në ndalimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe të gjuhës shqipe, shkollës shqipe dhe madje në fund (xhonturqit) dhe armëve në duart e shqiptarëve?! Kanë luftuar me rusët, por perandoria dhe shteti më vonë turk ka toleruar më tepër sllavët si maqedonë, bullgarë, serbë dhe të tjerë plot si malazezë në dëm të shqiptarëve?! Si Perandoria Osmane, edhe shteti otoman dhe Turqia më vonë kanë investuar dhe ndërtuar më pak në territorin shqiptar se kudo në zonën perëndimore të gjeografisë së tyre pushtuese. Në territorin shqiptar nga perandoria është ndërtuar më pak në rrugë, në urbanizim, në krijim kushtesh banimi, në ura e pazare e po ashtu arsimim dhe madje dhe multikulturalizëm përveç duhet thënë e drejta në fund ose pranë vdekjes së saj. Shqiptarëve ju është rënë në qafë si muslimanë, si ortodoksë dhe si katolikë pikërisht shqiptarë. Ndryshe ka vepruar me pansllavizmin dhe ortodoksinë sigurisht më të fortë në sipërfaqet, shtetet dhe kishën e tyre. Kanë luftuar, por dhe kanë bërë pakte bashkë pothuaj si në ditët e sotme. Të dy, si pansllavizmi edhe otomanizmi janë idesë kombëtare shqiptare. Nuk është aspak jo në zhvillim sot në kohën e dy “perandorive” moderne si në Rusi dhe Turqi dhe pse vende sigurisht të pakteve të tjera sot. Turqia është një vend mik sigurisht, por neo otomanizmi ka punën e tij dhe miqësia nganjëherë i shërben me sy mbyllur! Të dyja kanë qëllimin në daljen e influencave të mëdha të dikurshme si pansllavizmi Rus me vëllezërit e tyre rreth nesh, dhe neotomanizmi i dalë tani qartë në Turqi. Rrëzohet një avion dhe kërkohet falje, bashkëpunohet për Sirinë dhe vritet nga një oficer turk një ambasador - këto janë vetëm format për të pasur një raport të ri, por mbi bazat e vjetra të dikurshme për ekspansion dhe pse jo - drejt Ballkanit perëndimor, përveç raportit të

vështirë me vendet demokratike të botës dhe Evropës perëndimore?! Por dhe kjo, sidomos tani pas ndërrimit të Presidentit dhe administratës në USA, ka problemet e mëdha të vetat?! Nuk besoj se po vjen në SHBA-të një administratë që e do kaq shumë BE-në?! As formën dhe as mënyrat e deritanishme të saj të Brukselit, të Gjermanisë dhe të Francës, por dhe vendeve të tjera liberale dhe tolerante në përgjithësi. Nga perëndimi ka kohë që fryn drejt nesh dhe vetë aty - era e intolerancës dhe nacional populizmit?! Baluardi i fundit i këtij shembulli në pushtet është Gjermania e Merkelit, e cila sot është sidomos mbasi “kamionit të çmendur mbi turmën në Berlin” nën sulmin e nacional populistëve në Evropë - Nigel Farage mbasi ndau Britaninë nga BE thotë se: faktet si ato në Berlin janë trashëgimi e Merkel”?! Kurse Marion Le Pen e Frontit Nacional Francez thotë se: terroristi islamik në Berlin (akoma nuk dihet nëse ishte apo jo) është një emigrant dhe Merkel është përgjegjëse?! Ajo shton madje se “në Francë dhe Evropë, duhen ndalur këto lider të papërgjegjshëm?! Ultranasionalisti Holandez Geert Eilders nxjerr në tēt një Merkel që ka duart me gjak?! Por akoma më shumë liderët e AFD-së gjermane dhe për më tepër Frauke Petry ka akuzuar zonjën Merkel - se ka gënjyer për sigurinë e Gjermanisë dhe i fejuari i saj Marcus Pretzell, anëtar i lartë i partisë thotë se: ato janë të vdekurit e Merkel, e cila ka duart e lara me gjakun e tyre?! Ndërkohë që Presidenti i zgjedhur Trump, i konsideron si Turqinë, Berlinin dhe Zvicrën bashkë - akte terroriste të cilat duhet të bëjnë ndërrimin e mendimit dhe sigurisht veprimit?! Në fakt në Turqi ishte një turk polic në Zvicër krejt gjë tjetër dhe në Gjermani akoma nuk dihet mirë?! Kurse sigurisht terrorizmi botëror vijon e kjo shkon si ide kundër lirisë dhe tolerancës, por shkon me shpejtësi pro mbylljes, intolerancës dhe shtetit nacional populist kudo?! Sigurisht ne jemi vend i vogël, por jemi në mes të rrugëve të tilla. Jemi pikërisht vendi në mes së këtyre erërave. Kemi qenë gjithmonë në fakt! Kautizmi dhe dyzimi - sa andaj kënde, përbëjnë problem të madh. Kurse ne fakt, ne kemi bërë zgjedhjen tonë. Ajo zgjedhje është perëndimi. Kulturalisht dhe politikisht në liri?! Ai është i vetmi vend ku ne mund të shikojmë interesa të vërteta dhe të drejta. Perëndimi mbase mund të bëjë shumë gabime, por është e sigurt që demokracia triumfon. Sigurisht që modelet e lindjes kanë sundimtarë dhe praktika klerikale të vështira, por perëndimi këto gjëra i ka mbyllur dhe asnjëherë nuk mund të fitojnë idiotët e intolerancës. Flas sidomos për perëndimin gjeografik tonin, që është Evropa e Bashkuar?! Në këtë rast asnjë dyshim dhe asnjë devijim, sepse sigurisht do të na kushtonte shumë shtrenjtë.

NIKË TOMA - NJERIU I BUKURISË FIZIKE E SHPIRTNORE

Para disa ditësh u nda nga jeta nj bir i shquar i Thethit dhe i Dukagjinit, një burra i nderuar e i respektuar, në moshën 85 vjeçare, e ky është Nikë Toma. Ai u lind në një familje me tradita të shquara patriotike, me nderë e fisnike, bukëdhënë e mikpritëse. Trualli ku u lind ishte pjesë e bukurisë natyrore të Thethit, çka bëri që ai të rritej si një lastarë i drejtë, i gjatë, i pashëm, me formin dhe edukatë të shëndoshë, me karakter të fortë, me shpirtë e zemër të madhe, krenar për vendlindjen e njerëzit me të cilët punoi e jetoi, i aftë për të përballuar sfidat e jetës, të cilat edhe pse nuk e përkdhelën, kurdoherë ai doli i fituar mbi to. Më e vështira, ndër të tjera ishte mungesa e djemve për shkak të emigracionit, e nipave e mbesave që i dontë dhe e donin aq shumë.

Nika u rrit jetim, pa nënë e babë, e kjo ishte e veçanta e jetës së tij, prandaj nuk mund të anashkaloj nënën e dytë, grua e axhes me emrin e bukur Bjeshkë, me shpirtë e zemër të pastër me një përkushtim të jashtëzakonshëm për Nikën, ma dashuri, ëmbëlsi, më njerzillëk e sinqeritet të plotë në një mjedis të ngrohtë për rritjen e tij, për t'u bërë ashtu siç u bë Nika, i stolisuar me cilësitë më të mira të malësorit, i thjeshtë, i dashur, i respektueshëm, jo vetëm për ata që e rritën, por i përkushtuar për t'u shërbyer njerëzve me devotshmëri. Nikë dhe Bjeshka u bënë një gjithnjë së bashku edhe pse ajo lindi dy djemtë e saj, gjithnjë së pari me Nikën. Për Nikën, Bjeshka, nënë e kaluar nënës. Këto cilësi u bënë pjesë e jetës së tij, në shkollë, në rini, në aksionet e saj, kudo ku punoi deri sa Thethi u bind, duke e zgjedhur Kryetarin e parë, vendas, të ekonomisë së tyre kolektive. Ai nuk i zhgënjeu, por

duke u vënë në ballë të punës për një zhvillim dhe progres të gjithanshëm, për rritjen e nivelit arsimor dhe kulturor. Ai u bë iniciatori për elektrifikimin e fshatit, i pari në zonat malore, për zgjerimin e shërbimeve sociale, në veçanti për



shkollën 7-8 vjeçare, për vatrën e kulturës, për qendrën shëndetësore, për rrugët e fshatit, e te tjerë.

Me dashurinë dhe përkrahjen e Thethit, Nika u rrit, u burrnua, u bë kuadër i devotshëm reciprokisht të nevojshëm për njëri tjetrin. Në këtë mjedis, ai krijoi familjen e tij. Me Tonen, bashkëshorten e tij, lindën dhe rritën katër fëmijë, dy djem dhe dy vajza, Mirandën, Prekën, Dranden dhe Plumbin, model për moral dhe cilësi të larta njerzore, një krenari e kënaqësi e madhe për Nikën, sepse në vazhdimësi, ata krijuan familjet e tyre me dy nuse dhe dy dhëndrra të spikatur, duke sjellur në jetë mjaltin e mjaltit, nipa e mbesa që e

deshën aq shumë gjyshin e tyre.

Nika, pas një periudhe gati 10 vjeçare në krye të ekonomisë së Thethit, kaloi në organet e pushtetit vendor si kryetar i Këshillit të Bashkuar, në fillim në Kelmend e me në fund në Postrinë. Në këto

dy zona, Nika punoi me ndërgjegje të lartë, ndaj shpejt fitoi besimin dhe respektin e banorëve të këtyre zonave, secila me veçoritë dhe vështirësitë e veta. Ai përfaqësoi në mënyrën më të mirë dukagjinasin e vërtetë, burrë i fjalës, i besës dhe i kuvendit.

Vdekja e Nikës e parakohshme dhe e papritur, piklloi thellë zemrat tona, jo vetëm të familjes e të afërmeve të tij, por edhe të shokëve, miqëve, e dashamirëve të shumtë, gjë e cila u pa nga pjesëmarrja masive në ceremoninë mortore dhe në përcjelljen për në banesën e fundit, me dhimbje e lot në sy bashkëfshatarë, bashkëkrahinarë nga ato zona ku punoi e

jetoi, si në Grudën e Re, në Hotin e Ri, të vjetër e të rinjë, nga fshati e nga qyteti.

Edhe Shoqata atdhetare "Dukagjini", si anëtar i dëgjë i saj, e nderoj Nikën me kurorë dhe përshendetjen e lamtumirës nga z. Luigj Shyti, si sekretar i saj, por edhe në emër të thethjanëve, të cilët e ndjenë më shumë humbjen e tij.

Unë, autori i këtij shkrimi, në moshën 20 vjeçare e njoha para më shumë se gjysëm shekulli, kur u emrova drejtor i shkollë 7 vjeçare të Thethit, e Nika ishte kryetar i kooperativës bujqësore. Ai dha një kontribut të veçantë për shkollën, për të siguruar kushte të përshtatshme për jetesën e mësuesve që zakonisht ishin nga qyteti e zonat fushore, por edhe për mua si djalë i ri që isha, duke më dhënë kurajo e mbështetur në punën time. Këtu u hollën themelet e një shoqërie të re, pa "shibla" e cila u shtua e u shtri gjerësisht edhe në familjet tona e të pandërprera deri në ditën e fundit të jetës së tij. Shoqëria jonë e pastër, e sinqertë, pati jetëgjatësi sepse u ushqye me dashuri e respekt të thellë, me mall kur ishim larg njëri - tjetrit. Për mua ishte privilegj të kishe një shok të tillë si Nika, sepse i tillë ishte ai, i dashur, njerzor, gojëmbël, zemërbardhë, shumë human, që urrënte mendjemadhësinë, kapadaillekun duke qenë i barabartë midis të barabartëve. Këto cilësi që kishte Nika, janë vlera të vërteta të cilat do t'i ruaj e kujtoj gjatë gjithë jetës time. Me këtë rast, unë, ngushilloj familjen e tij, Tonen, vajzat, djemtë, dhe kërkoj që dhimbjen e thellë ta përballojnë të fortë, me kokën lart e krenar për emrin e mirë që u la Nika, për kënaqësinë time, të shokëve e gjithë dashamirësve tuaj. Unë do të jem pjesë e dhimbjen, por edhe e kranarisë tuaj.

NDOC GRIMAJ

*** Kuriozitete *** Kuriozitete *** Kuriozitete *** Kuriozitete *** Kuriozitete ***

Këta janë 10 njerëzit më të pasur të gjitha kohërave

Kush kishte më shumë para, John Rockefeller apo Xhengis Khani? Është një pyetje e thjeshtë por me përgjigje të vështirë. Kjo radhitje e njerëzve më të pasur të të gjitha kohërave është bazuar në disa orë intervistash me ekonomistë e historianë akademikë, shkruan revista TIME. Ishte e vështirë të bëje një listë të tillë, duke krahasuar pasuritë e njerëzve të ndryshëm në kohë e sisteme ekonomike të ndryshme.

10. Xhengis Khan (1162-1227), Vendi: Perandoria Mongole, Pasuria: Shumë tokë, jo shumë gjëra të tjera. Xhengis Khan është padyshim një nga udhëheqësit ushtarakë më të suksesshëm të të gjitha kohërave. Si lider i Perandorisë Mongole, që në kulmin e saj shtrihej nga Kina në Evropë, ai kontrollonte perandorinë

më të madhe të historisë. Megjithatë, pavarësisht pushtetit të tij të madh, dijetarët thotë se Çengisë kurrë nuk e kursente pasurinë. Përkundrazi, bujaria i tij ishte çelësi i ndikimit e suksesit. "Një nga bazat e suksesit të tij ishte ndarja e plaçkave me ushtarët dhe komandantët e tij" thotë Morris Rosasabi, profesor i shquar i historisë në Kolegjin Cuny's Queens. Autori i librit "Xhengis Han dhe Bota Moderne", Jack Weatherford, shpjegon se të gjitha sendet e marra nga një zonë e pushtuar, u ndaheshin ushtarëve dhe familjeve të tyre. "Ai nuk ndërtoi pallat për veten apo familjen e tij, asnjë tempull, asnjë varr, madje as një shtëpi", thotë Weatherford. "Ai pati një vdekje si njeri normal, e më pas u dogj".

9. Bill Gates (1955-...) Vendi: SHBA, Pasuria: 78.9 miliardë dollarë. Si personi më i pasur në botë që akoma jeton, pasuria e Bill Gates është e lehtë për t'u përcaktuar. Këtë vit, revista Forbes e vlerëson vlerën neto të pasurisë së themeluesit të Microsoft në 78,9 miliardë dollarë. Janë 8 miliardë më shumë se bashkëthemeluesi i ZARA-s, Amancio Ortega, personi i dytë më i pasur në botë.

8. Alan Rufus (Alan i Kuq) (1040-1093), Vendi: Angli, Pasuria: 194 miliardë dollarë. Nipi i William Pushtuesit, Rufus iu bashkua xhaxhait të tij në pushtimin norman. Ai vdiq me 11 mijë paund, sipas Philip Beresford dhe Bill Rubinstein, autorët e librit "Më të pasurit e të pasurve". Ata zotëronin 7 % të Prodhimit të Përgjithshëm Bruto të Anglisë në atë

kohë. Sot kjo pasuri do të ishte 194 miliardë dollarë.

7. John D. Rockefeller 1839-1937, Vendi: SHBA, Pasuria: 341 miliardë dollarë. Rockefeller filloi të investonte në industrinë e naftës në vitin 1863 dhe në vitin 1880, kompania e tij Standard Oil kontrollonte 90% të prodhimit të naftës në Amerikë. Sipas New York Times, Rockefeller kishte një pasuri që ishte ekuivalente me pothuajse 2% të prodhimit ekonomik amerikan. Kjo pasuri sot do të shkonte në 341 miliardë dollarë.

6. Andrew Carnegie (1835-1919), Vendi: SHBA, Pasuria: 372 miliardë dollarë. Rockefeller ka qenë kryefjala e shtypit, por Andrew Carnegie mund të jetë amerikani më i pasur i të gjitha kohërave. Emigranti

skocez shiti kompaninë e tij US Steell tek J. P. Morgan për 480 milionë dollarë në vitin 1901. Kjo shumë mendohet të ishte sa 2.1 % e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto të Shteteve të Bashkuara duke i dhënë një pasuri ekonomike Carnegie-së, që sot do të ishte ekuivalente me 372 miliardë dollarë.

5. Joseph Stalin (1878–1953), Vendi: Bashkimi Sovjetik, Pasuria: Kontrolli i të gjithë vendit me 9. 6% GDP globale. Stalini është një figurë e pazakontë në historinë moderne ekonomike: një diktator me pushtet absolut që kontrollonte një nga ekonomitë më të mëdha në botë. Ndërsa është virtualisht e pamundur të ndash pasurinë e Stalinit nga pasuria e Bashkimit Sovjetik, kombinimi i tij unik i ekonomisë dhe kontrollit total të Bashkimit Sovjetik, shtynë shumë ekonomistë ta nominonin atë si një prej njerëzve më të pasur të gjitha kohërave. Është e lehtë të besosh logjikën e tyre. Të dhënat nga OECD tregojnë se në vitin 1950, tre vjet pas vdekjes së Stalinit, Bashkimi Sovjetik përfshinte afro 9. 5 % të prodhimit global ekonomik. Në kohën tonë ky nivel prodhimi do të ishte i barabartë me 7. 5 trilion dollarë. Ndërsa këto para nuk i përkisnin Stalinit drejtpërdrejt, ai kishte aftësinë të menaxhonte fuqinë ekonomike sovjetike si të donte. “Ai kishte pushtet absolut, dhe me pushtetin e tij mund të kishte çfarë të donte”. Kontrollonte 1 / 6 e sipërfaqes së Tokës. Megjithatë nuk është e sigurt nëse duhet ta konsiderojmë atë si një nga njerëzit më të pasur të gjitha kohërave sepse në të vërtetë nuk ishte pasuria e tij, por e vendit të tij. Por prapëseprapë vështirë se mund ta lësh atë jashtë listës.

4. Akbar I (1542–1605), Vendi: Indi, Pasuria: Udhëhiqte perandorinë me 25 % të GDP-së globale. Perandori më i madh i dinastisë indiane, Akbari kontrollonte një perandori që përfshinte ¼ të prodhimit ekonomik global. GDP-ja e Indisë ishte e krahasueshme me pasurinë e Anglisë Elizabetiane, por me një jetesë ekstravagante që e tejkalonte atë të shoqërisë evropiane. Pohimi se klasa elitare e Indisë ishte më e pasur se homologet e saj në perëndim është mbështetur edhe nga të dhënat e ekonomistit Branko Milanovic, kërkimet e të cilit tregojnë se Dinastia Mugal ishte një nga perandoritë më efektive të të gjitha kohërave që nxirrte pasuri nga popullsia.

3. Perandori Shenzong (1048–1085). Vendi: Kinë. Pasuria: Udhëhiqte perandorinë me 25-30 % të GDP-së globale. Dinastia kineze Song (960-1279) ishte një nga perandoritë më të fuqishme ekonomisht të të gjitha kohërave. Sipas profesor Ronald Eduards, një historian kinez ekonomie, tha se vendoi përfshinte mes 25-30% të prodhimit ekonomik botëror gjatë kulmit të saj. Pasuria e perandorisë erdhi nga inavocionet teknologjike dhe aftësia ekstreme në mbledhjen e taksave, gjë për të cilën Eduards thotë se ishte qindra vjet përpara qeverive evropiane. Profesori gjithashtu theksoi se qeveria e Perandorisë Song ishte e centralizuar, që do të thoshte se perandori kishte kontrollin më të madh në perandori.



2. Cezar Augusti (63 para erës sonë –14 pas erës sonë). Vendi: Romë. Pasuria: 4. 6 trilionë dollarë. Nuk ishte vetëm Cezar Augusti në krye të perandorisë që përfshinte 25-30 % të prodhimit ekonomik botëror, por sipas profesorit të historisë në Stanford, Ian Morris, Augusti në një moment kishte pasuri personale të barabartë me 1/5 e ekonomisë së perandorisë së tij. Sot ajo pasuri do të ishte ekuivalente me 4.6 trilion dollarë. “Për ca kohë,” tha Morris, “Augusti zotëronte të gjithë Egjiptin”.

1. Mansa Musa (1280–1337). Vendi: Mali. Pasuria: Aq i pasur sa vështirë ta përshkruash. Mansa Musa, mbreti i Timbuktu, shpesh përmendet si personi më i pasur i historisë. Sipas profesorit të historisë Richard Smith, mbretëria afrikano-perëndimore e Musa-s ishte me shumë gjasa prodhuesja më e madhe e arit në botë, në një kohë kur kërkesa për arin ishte shumë e madhe. Nuk mund t’i caktoje një shifër pasurisë së Musas. Regjistrimet janë të pakta, në mos inekzistente, dhe burimet bashkëkohore e përshkruajnë pasurinë e mbretit si diçka e papërshkrueshme dhe e pamundur.



Disa tregime të pelegrinazhit të tij të famshëm në Mekë, gjatë të cilit shpenzimet e tij ishin aq të mëdha sa e futën në krizë monedhën egjiptiane të asaj kohe, thonë se ai përdorte dhjetëra deve që mbanin qindra kilogramë ar. Të tjerë thonë se ushtria e Musas përbëhej nga 200 mijë burra, përfshi 40 mijë harkëtarë, shifra të cilat edhe superfuqitë moderne do të kishin vështirësi t’i nxirrnin në betejë. Një

profesor historie nga Universiteti i Miçiganit, Rudolph Ware, thotë se pasuria e Musas ishte aq e madhe sa njerëzit ‘luftonin’ për ta vlerësuar atë. “Nuk ka fjalë që e përshkruajnë pasurinë e tij. Ekzistojnë piktura të tij, të ulur në një fron të artë, duke mbajtur një filxhan ari, me një kurorë të artë mbi kokë. Kur askush nuk mund t’i vërë emër pasurisë tuaj, atëherë po që jeni të pasur.

PËRUIROHET KAPELA E SHËN TEREZËS NË BRUKSEL



E diela 3 shtatorit 2017 ka mbledhur shqiptaret që punojnë e jetojnë në Belgjikë Luksemburg, Angli në ceremoninë e inaugurimit të kapelës kushtuar Shën Terezës në Banneux vendi ku është shfaqur Zoja e Bekuar në vitin 1933. Është puna disa mujore e komunitetit katolik shqiptar që ne 1vjetorin e Shenjtërimit dhe 20 vjetorit e kthimit tek Ati. Shqiptaret të ardhur nga gjithë vendbanimet e tyre janë mbledhur në vendin ku është shfaqur Zoja e Bekuar ose siç njihet Zoja e të Varfërve. Në këtë ceremoni festive bie në sy pjesëmarrja e të gjitha moshave, kostumet kombëtare dhe flamuri shqiptar. Është ky vend që shenjtëria shqiptare do të jeta e pranishme pranë Zojës së Bekuar. Të pranishmit në fjalën e mirëseardhjes i ka përshëndetur rektori i shenjtërores së Virgjërës së të Varfërve At Leo Palm, i cili ka pranuar që krahas shteteve të

tjera dhe Shqipëria të përfaqësojnë me shenjtëroren me famë botërore. Më pas të pranishmit në lutje kanë nisur precesionin duke prirë statuja të Shën Terezës. Besimtarët në lutje janë ndaluar në tre ndalesat ku është dhe ndalesa e Virgjës Mari, e cila është shfaqur 8 herë nga 15 janari deri 3 mars 1933, gjithmonë në orën 19. Të pranishmit i ka përshëndetur kryetari i komunitetit katolik shqiptar Ndue (Kin) Kukaj ku ka falënderuar të gjithë shqiptarët për përkrahjen e ndërtimit të kësaj kapele me ndihmën financiare e materiale. Prerja e shiritit të inaugurimit të kapelës së Shën Terezës u bë nga përfaqësuesia misionareve të bamirësisë motër Albertina dhe Ndue (Kin) Kukaj. Me pas At Gary Walsh ka kryesoj ritin e bekimit të kapelës. Kjo kapelë është e ndërtuar në ambientet e shenjtërores. Kapela e Shën Terezës në

Banneux paraqet një replikete kapelave që gjenden në secilën shtëpi të motrave Misionare të Bamirësisë. Truporja është realizuar nga një skulptore spanjolle Mara Jose nga Madridi. Truporja e vendosur është dhuratë nga motra AnaMC që është motra kryesore për Mbretinë e Bashkuar dhe Irlandën. Kapela Shën Terezës në Banneux kryqi qëndron në vendin kryesore me thenjen "I thirst" kam etje. Në katër shtyllat janë varur xhama me thënje të Shenjtores shqiptare në të cilën kujton origjinin e sajë si dhe vend për vendosjen e qirave, letra për shtegtarët. Pjesëmarrësit më pas kanë ndjekur meshën në shenjë falënderimi në kapelën shën Françeskut të Asizit, të cilën e kremtojnë At Gary Walsh dhe bashkëkremtuesi don Frrok Zefi. Në fjalën e perdikimit misionarët kanë falënderuar komunitetin katolik shqiptar që jeton

në Belgjikë duke ju kujtuar besimtarëve më shumë harmoni e dashuri mes njeri-tjetrit për të ecur në shembullin e Nënë Terezës. Atmosfera e festës ka vazhduar me një koktej ku familjet e emigraneve shqiptarë në Belgjikë, Luksemburg, Angli, dhe Hollandë kanë ndarë mes njeri-tjetrit jetën në emigracion. Kjo kapelë nga sot do të jenë një pikë takimi e lutje për shqiptarët dhe një pasaportë njohje për kombet e tjera që kanë pake njohuri për Shqipërinë. Në këtë inagurim të rëndësishëm ishin të pranishëm dhe përfaqësuesit e trupit diplomatik shqiptar e Kosovës.

*Përgatitur nga Zef Nika,
Banneux-Belgjik,
me 3 shtator 2017*

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

